

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5404
E premte, 16 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Në dhjetëvjetorin e pavarësisë, Barbadosi njih Kosovën ■ FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE

NJË DEGENIE PAVARËSI E SOVRANITET F.12

Salihe SALIHU -
PhD kandidat



KRYEPROKURORI I GJYKATËS SPECIALE LARGOHET NGA DETYRA F.2

REXHEP SELIMI: 10 VJET PENGESA, PAK TË ARRITURA F.5

UP-JA SHËNON 48-VJETORIN E THEMELIMIT F.6

EKONOMI

KOSOVA PËRFITON 38.5 MILIONË EURO PËR REHABILITIMIN E HEKURUDHAVE F.7

MBPZHR-ja JEP SUBVENCIONE PËR DISA KULTURA DHE VEPRIMTARI BUJQËSORE F.7

KULTURË

NË 10-VJETORIN E PAVARËSISË, MKRS-ja DHA ÇMIMET PËR LETËRSI F.15

SPORT

ALBINI, I 50-ti NË GARËN E LËSHIMIT F.16

KOSOVA DHE SHQIPËRIA NGREHEN NGA NJË POZITË F.16



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI

Nuk u shfrytëzuan mundësitë sa duhet për ta konsoliduar shtetin

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se në këtë dhjetëvjetor të shtetësisë Kosova ka të arritura të cilat nuk mund të mohohen, por janë shumë të vogla. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka theksuar se mundësitë për të qenë një shtet i

ndërtuar dhe konsoliduar nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Sipas tij, në shumë raste këto mundësi u keqpërdoren më së shumti nga të zgjedhurit e popullit. Krasniqi ka bërë thirrje për unitet për ecjen e mëtutjeshme të shtetit. "Ashtu siç e kemi koordinuar rrugën deri te pavarësia,

ashtu duhet të vazhdojmë. Sigurisht na pret një punë e madhe dhe e përgjegjshme", ka thënë Krasniqi, i cili për çdo ngecje, për moszhvillim të vendit, për mospërbushje të standardeve të kërkuara nga faktori ndërkombëtar, fajtorë i ka bërë udhëheqësit e vendit

EDITORIAL I HASHIM THAÇIT, PRESIDENT I KOSOVËS

Jubileu i parë i shtetit të Kosovës

Shteti i Kosovës është një rrëfim i suksesshëm dhe krenar i të gjithë kosovarëve. Këtë kurrë nuk duhet ta harrojmë të gjithë

ne, që kemi privilegjin, nderin dhe përgjegjësinë për të qenë në shërbim të këtij shteti dhe të qytetarëve të tij... ■ FAQE 3



Ratifikimi i demarkacionit kërkon unitet politik

Pas vizitës së kryeministrit malazez Dushko Markoviq, disa prej liderëve institucionalë kanë bërë me dije se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi kërkon unitet politik. Sipas tyre, vetëm në këtë mënyrë mund të

hapet rruga për liberalizim të vizave. Edhe njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur optimizëm se pas vizitës së kryeministrit malazez në Kosovë mund të lëvizet përpara në këtë çështje

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ish-zëvendëspresidenti i ShBA-së, Joseph Biden, ka uruar presidentin Thaçi për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës

Biden: ShBA-ja gjithmonë do të jetë mike e vërtetë e popullit të Kosovës

"Sot, ndërsa po festoni sukseset tuaja të shumta, e dini se Shtetet e Bashkuara janë, kanë qenë dhe gjithmonë do të jenë mike e vërtetë e popullit të Kosovës", thuhet në urimin e ish-zëvendëspresidentit të ShBA-së, Joseph Biden, dërguar presidentit Hashim Thaçi për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës

PRISHTINË, 15 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në prag të shënimit të dhjetëvjetorit të pavarësisë, ka pranuar një letër urimi nga ish-zëvendëspresidenti i ShBA-së, Joseph Biden. Ai ka thënë se me krenari dhe kënaqësi të jashtëzakonshme ofron urimet më të thella për presidentin dhe popullin e Kosovës në përvjetorin e dhjetë të pavarësisë. "Siç e dini, gjithmonë kam besuar në premtimin e popullit të Kosovës për të ndërtuar një shtet të rrënjësor në vlerat themelore të drejtësisë dhe barazisë.

Në një dekadë të shkurtër, ju me vendosmëri keni zhvilluar një betejë për pavarësi, jeni mirëpritur në bashkësinë e kombeve, keni ndërtuar një demokraci përfaqësuese, ku zgjedhjet e lira dhe të drejta janë shndërruar në normë dhe kodifikimi i të drejtave të njeriut është bërë ligj. Ju tani keni

vendosur themelet e forta të një shteti demokratik. Organizatat joqeveritare janë aktive, qytetarët lirshëm debatojnë për çështjet ditore dhe veprimet e tolerancës dhe pajtimit e pikëzojnë peizazhin", thuhet në letrën e Bidenit.

Ai ka thënë se një nga udhëtimet e para që kam bërë si zëvendëspresident ishte ta vizitoja Kosovën më 2009. "Vizita që i bëra vendit disa vjet më vonë ishte gjithashtu një nga vizitat e mia të fundit zyrtare si zëvendëspresident. Isha shumë i impresionuar për ta parë nga afër progresin e shënuar në atë kohë të shkurtër falë guximit të patrembur dhe këmbënguljes së palëkundur të popullit të Kosovës. Ndërsa, atje ka ende shumë punë që duhet bërë, por ju po lëvizni me shpejtësi për t'u bërë një demokraci plotësisht e integruar evropiane - një demokraci në paqe me fqinjët e saj në të cilën të gjithë qytetarët trajtohen me din-



jitet", ka shkruar ish-zëvendëspresidenti amerikan.

"Kosova dhe qytetarët e saj janë të vendosur thellë në zemrat e tërë familjes Biden. Kam rënë në dashuri me vendin tuaj në vizitën time të parë si një senator i ri i ShBA-së në mesin e viteve '70. E njëjta vlen edhe për djalin tim, Beau, i cili në pjesën më të mirë të një viti jetoi dhe punoi në Kosovë, më 2001, për të ndihmuar në avancimin e sundimit të së drejtës - një nga qëllimet më të rëndësishme të çdo shteti të ri të pavarur. Dhe çdo pjesëtar i ardhshëm i familjes Biden që do

të bëjë pelegrinazh për ta vizituar autostradën e emëruar në nder të Beau-t, jashtë kampit Bondsteel, sigurisht do të ndihet aq thellësisht pjesë e suksesit tuaj të vazhdueshëm, ashtu siç ndihem unë", ka shkruar Biden. "Kam besim se qytetarët e këtij vendi të madh do të vazhdojnë të ndërtojnë një Kosovë të qëndrueshme, të lirë, demokratike dhe të begatë - një Kosovë që manifeston shpresat dhe ëndrrat shumëvjeçare. Dhe unë besoj se me një Kosovë të tillë edhe vetë bota do të jetë më e mirë", ka theksuar Biden.

Ai ka thënë se ndërsa sot po festoni sukseset tuaja të shumta, e dini se ShBA-ja ka qenë dhe gjithmonë do të jenë një mike e vërtetë e popullit të Kosovës. "Ne u gëzohemi sukseseve tuaja dhe do të punojmë për t'ju ndihmuar që t'i tejkaloni sfidat me të cilat përballen të gjitha demokracitë. Dhe e di se edhe personalisht vazhdoj të qëndroj me popullin e Kosovës. Shpirti juaj është i lirë, i palodhshëm dhe e ardhmja juaj është e ndritshme. Po pres me padurim se çfarë do të sjellin dhjetë vjetet e ardhshëm", ka shkruar Biden.

Kryeprokurori i Gjykatës Speciale largohet nga detyra

Kryeprokurori i Gjykatës Speciale, David Schwendiman, ka thënë se nuk po jep dorëheqje dhe as nuk po shkarkohet. "Kjo duhet të ndodhë sepse administrata amerikane nuk mund të bëjë përjashtim për statusin tim si pensionist i rimarrë në shërbim, diçka që ligji nuk më lejon ta ndryshoj, pavarësisht nga sa shumë mund të dëshiroj të qëndroj", thuhet në një deklaratë të prokurorit Schwendiman

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Përmes një komunikate me shkrim, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar të enjten se David Schwendiman është larguar nga detyra për shkak të skadimit të emërimit të tij për afatin e caktuar për tre vjet si një oficer i lartë për Shërbim të Jashtëm në Departamentin Amerikan të Shtetit.

Schwendiman do të largohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 31 mars 2018

kur emërimi i tij do të marrë fund. Përmes një deklaratë për medie, ai ka bërë të qartë se nuk po jep dorëheqje dhe as nuk po shkarkohet. "Kjo duhet të ndodhë sepse administrata amerikane nuk mund të bëjë përjashtim për statusin tim si pensionist i rimarrë në shërbim, diçka që ligji nuk më lejon të ndryshoj, pavarësisht nga sa shumë mund të dëshiroj të qëndroj", thuhet në një deklaratë të prokurorit, Schwendiman. Pas largimit të Schwendiman,



Kwai Hong Ip, zëvendësi i tij, do të marrë përsipër detyrën si Prokuror i Specializuar i Përkohshëm që të sigurohet vazhdimësi në punën e filluar. Pas deklaratës së lëshuar nga Prokurori i Specializuar, David Schwendiman, në lidhje me

përfundimin e ushtrimit të funksionit të tij, prej 31 marsit 2018, kryetarja e Dhomave të Specializuara apo e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, ka folur për largimin e tij. Trendafilova ka lavdëruar punën e deritanishme të

Schwendimanit, për të cilin ka thënë se prej emërimit të tij në detyrë, ai ka punuar në mënyrë këmbëngulëse për jetësimin e mandatit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. "Që prej emërimit ai ka punuar në mënyrë këmbëngulëse për jetësimin e mandatit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, për të mundësuar hetime dhe procedime penale të drejta, të paanshme, efikase dhe të pavarura të pretendimeve për krime brenda juridiksionit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke i kushtuar kujdes të posaçëm mbrojtjes së dëshmitarëve të mundshëm", ka thënë Trendafilova.

Ajo ka shprehur qëndrimin se të dy institucionet, Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, do ta vijojnë pa ndërprerje punën për përmbushjen e mandatit të tyre.

Jubileu i parë i shtetit të Kosovës



Editorial i Hashim THAÇIT,
president i Kosovës

Shteti i Kosovës është një rrëfim i suksesshëm dhe krenar i të gjithë kosovarëve. Këtë kurrë nuk duhet ta harrojmë të gjithë ne, që kemi privilegjin, nderin dhe përgjegjësinë për të qenë në shërbim të këtij shteti dhe të qytetarëve të tij

Dita më e rëndësishme në historinë e Kosovës është 17 shkurti i vitit 2008. Në këtë ditë u lind shteti i Kosovës dhe kështu të gjithë ne qytetarët e lirë të këtij vendi, u bëmë me shtëpinë tonë të përbashkët shtetërore, u bëmë shtetas të Kosovës.

Secili prej nesh e kemi një rrëfim tonin individual dhe familjar se çka bëmë atë ditë shumë të ftohtë të dimrit, si i kaluam ato orët para se të mblidhej Kuvendi i Kosovës, në seancën e paharrueshme të tij, si u gëzuam çastit kur me Deklaratën e miratuar në Kuvend, ne vendosëm për fatin tonë, njëherë e përgjithmonë, duke e shpallur Kosovën shtet të pavarur.

Ishte ai çasti më i lumtur për të gjithë ne si popull, çast i përjetësisë për qytetarët e këtij vendi që, si rrallë ndonjë vend tjetër në këto anë të Evropës, e ka të mbushur historinë me tragjedi, me vuajtje, me heroizma dhe me dashuri për atdheun.

Me pak fjalë, ju, qytetarët e Kosovës, shfaqët mendimin më të sinqertë, më të bukur, më të dashur, atë 17 shkurt, kur thatë një herë: 'Bac u kry', duke i referuar komandantit legjendar Adem Jasharit, pastaj 'Edhe unë kam shtet', që i rrinte mirë trashëgimisë së presidentit historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovës.

Dhjetë vjet në jetën e një individi, të një familje, janë shumë, gjithqysh shumë, ndërsa në jetën e përbashkët të një populli, të një shteti, ato mund ta kenë peshën vendimtare për fatin e tij, ato mund të paralajmërojnë saktësisht të ardhmen e tij, siç është rasti me ne, në Kosovë.

Kam pasur nderin më të madh në jetën time, që të dielën e 17 shkurtit të vitit 2008, në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në emër të të gjithë qytetarëve të Kosovës, në respektim të një historie të lavdishme të këtij populli, në paralajmërim të ardhmënisë së ndritshme të këtij vendi, ta shpall shtetin e Kosovës.

E di mirë që pa qytetarët e Kosovës, pa atë vullnetin e paparë të tyre për të flijuar gjithçka për lirinë e këtij vendi, mbi të gjitha, jetën e tyre, ne kurrë nuk do të mbërrinim te krijimi i shtetit të Kosovës.

Ky shtet është një rrëfim i suksesshëm dhe krenar i të gjithë neve. Secili prej qytetarëve

të tij ka hise në bërjen e këtij shteti.

Këtë kurrë nuk duhet ta harrojmë të gjithë ne, që jemi në ballë të institucioneve të Republikës së Kosovës, që kemi fatin, privilegjin, nderin dhe përgjegjësinë për të qenë në shërbim të këtij shteti dhe të qytetarëve të tij.

E di mirë, po ashtu, që ne të gjithë, kurrë nuk do të mbërrinim ta përcaktonim fatin tonë, të bëheshim të lirë dhe ta krijojmë shtetin e Kosovës, pa ndihmën e madhe politike, ushtarake, ekonomike, e mbi të gjitha, njerëzore dhe miqësore të ShBA-së, dhe të shteteve të tjera kryesore perëndimore.

U bëmë bashkë një herë ne të gjithë në Kosovë, e pastaj, edhe me ShBA-në, me Evropën, me Botën e lirë dhe demokratike, për ta bërë këtë popull, këtë vend, këtë Kosovë, këtë shtet të lirë dhe demokratik.

Liria dhe shteti i Kosovës janë në realitet vlera supreme të qytetërimit evropian dhe perëndimor.

Kosova dhe populli i saj, sot e kësaj dite, janë qytetarët dhe shteti më pro-amerikan, më pro-evropian, më pro-perëndimor në këtë anë të Botës.

E për këtë fakt jemi krenar.

Këta dhjetë vjetet e para të ekzistencës së shtetit të Kosovës mund t'i matim gjithqysh, apo mund të ketë shumë njësi matëse për këtë dekadën e parë të shtetit të Kosovës.

Pavarësinë e Kosovës e kanë pranuar 114 shtete, në mesin e tyre edhe shtetet më të rëndësishme të Perëndimit dhe të Evropës. Në vitin 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë konfirmoi të drejtën tonë për të qenë shtet.

Në vitin 2012 përfundua periudhën e mbikëqyrjes së pavarësisë.

Në vitin 2013 kemi nënshkruar Marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke hapur kështu udhë për integrimin e plotë të veriut të vendit në sistemin politik dhe juridik të Kosovës.

Në vitin 2015 nënshkruam Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian.

Demokracia në Kosovë ka lëshuar rrënjë të thella dhe ne tani jemi në gjendje t'i mbajmë zgjedhjet e lira vetë, si ato për pushtetin qendror, ashtu edhe ato për pushtetin lokal, të cilat janë shembull për rajonin.

Kemi krijuar institucione të qëndrueshme në të gjitha nivelet. Kemi shërbimin inteligjent, policinë dhe doganën më të mira në këto anë të Evropës. Kemi një FSK të shkëlqyeshme që së shpejti do të marr detyrat dhe misionin e një ushtrie të mirëfilltë moderne.

Kemi shënuar në vazhdimësi një zhvillim ekonomik që është më i larti në këtë pjesë të Evropës.

Kemi avancuar shumë marrëdhëniet ndëretnike në shtetin e Kosovës. Kemi ruajtur të pacenuar trashëgiminë e tolerancës ndërfetare në Kosovë.

Kosova merr pjesë në të gjitha garat sportive në botë. Sportistët valëvitin me krenari flamurin e Kosovës në të katër anët

e rruzullit tokësor. Majlinda Kelmendi fitoi medaljen e parë të artë olimpike dy vjet më parë në Olimpiadën e Rios.

Kosova i ka dhënë Evropës dhe botës këngëtare të famshme, ka bërë filma të çmuar në gjithë botën.

Lista e arritjeve dhe e sukseseve në shtetin e Kosovës dhe të shtetit të Kosovës, është shumë e gjatë. Kjo na bën të gjithëve krenarë.

Por, edhe kur shënojmë jubileun e parë të shtetit të Kosovës, ne duhet të jemi të sinqertë ndaj njëri-tjetrit, dhe të themi që duhet për të bërë edhe shumë që në Kosovë të fuqizohet rendi dhe ligji, që të sigurohet mirëqenia sociale për të gjithë qytetarët e Kosovës, që shteti i Kosovës të jetë konkurrent në të gjitha aspektet e mundshme ekonomike në Ballkan dhe në Evropë.

Të gjithë ne e dimë mirë që kemi merituar të ecim më shpejtë kah Bashkimi Evropian, që tashmë do duhej të ishim anëtarë të OKB-së dhe të gjitha organizatave të tjera ndërkombëtare, të nënshkruhej Marrëveshja finale për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të pavarura.

Sidoqoftë, e dimë kah do të ecim në javët, muajt dhe vitet e ardhshme.

Kemi vullnetin, vendosmërinë, sigurinë, besimin dhe shpresën që na bashkon të gjithëve në synimet tona.

Jam i sigurt që dhjetë vitet e kaluara kanë qenë vitet më të rënda, më sfiduese, më të vështira për shtetin e Kosovës, por njëloj kanë qenë vitet e krenarisë sonë të përbashkët.

Jam edhe më i sigurt që ata që jetojnë këtu, në atdheun tonë që është shtet prej 17 shkurtit të vitit 2008, pas dhjetë vjetësh, apo në shkurtin e vitit 2028, kur ta festojnë ditëlindjen e njëzetë të Republikës së Kosovës, do të shohin që Kosova ka ecur para me hapa të mëdhenj, që është bërë anëtare e OKB-së, e BE-së, e Paktit NATO, që ka një demokraci të qëndrueshme, që është bërë një shtet me stabilitet afatgjatë ekonomik dhe social, i cili, mbi të gjitha, ofron dinjitet dhe krenari për qytetarët e vet.

Gëzuar ditëlindjen e dhjetë të shtetit të Kosovës!

Qoftë i bekuar shteti i Kosovës përjetë dhe mot!





Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

Nuk u shfrytëzuan mundësitë sa duhet për ta konsoliduar shtetin

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se në këtë dhjetëvjetor të shtetësisë Kosova ka të arritura të cilat nuk mund të mohohen, por janë shumë të vogla. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka theksuar se mundësitë për të qenë një shtet i ndërtuar dhe konsoliduar nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Sipas tij, në shumë raste këto mundësi u keqpërdoren më së shumti nga të zgjedhurit e popullit. Krasniqi ka bërë thirrje për unitet në ecjen e shtetit tutje. "Ashtu siç e kemi koordinuar rrugën deri te pavarësia, duhet ta vazhdojmë. Sigurisht na pret një punë e madhe dhe e përgjegjshme", ka thënë Krasniqi, i cili për çdo ngecje, moszhvillim të vendit, për mospërmbushje të standardeve të kërkuara nga faktori ndërkombëtar, i ka fajësuar udhëheqësit e vendit

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 15 SHKURT - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë të enjten se rrugëtimi i Kosovës deri tek pavarësia e saj ka qenë i gjatë dhe i vështirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se e arritura më e madhe e dekadës së fundit ka qenë dhe mbetet shpallja e pavarësisë së Kosovës. "Për të ardhur deri te çlirimi i shtetit të Kosovës kanë punuar, luftuar dhe sakrifikuar

gjenerata dhe breza të tërë atdhetarësh. Janë shumë pak për një shtet dhjetë vjet pavarësi, por për ne dhe brezat që do të vijnë shtetësia e Kosovës, çdo minutë, çdo sekondë dhe çdo çast i saj do të jenë lumturi dhe perspektivë! Ne dolëm nga lufta, me shumë të vrarë e të plagosur, të shkatërruar fizikisht e shpirtërisht, shtëpi të djegur, ekonomi të shkatërruar, infrastrukturë të dobët, por me një vullnet të fortë për ta ndërtuar shtetin e ëndërruar me shekuj. Suksesi më i madh i mundshëm është vetë

pavarësia e Kosovës. Janë institucionet e shtetit, njohjet ndërkombëtare etj. Ka të arritura të cilat nuk mund të mohohen, por janë shumë të vogla, duke pasur parasysh pasuritë tokësore dhe nëntokësore, resurset njerëzore dhe gatishmërinë e disave për të punuar vërtet për ndërtimin e këtij shteti", ka deklaruar Krasniqi. Sipas tij, ka pasur shumë mundësi të cilat nuk janë shfrytëzuar në mënyrë që Kosova të bëhej një shtet me të cilin do të krenoheshin të gjithë, edhe ata që kanë rënë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Ai ka thënë se lëkundjet e partneritet me vendet mike nuk është dashur të ndodhin fare. Sipas Krasniqit, ashtu siç është koordinuar rruga deri te pavarësia, duhet të vazhdojë. Ai ka thënë se vendin e pret një punë e madhe dhe e përgjegjshme. "Mundësitë për të qenë një shtet i ndërtuar dhe konsoliduar, për të qenë një shtet me të cilin do të krenoheshin të gjithë heronjtë dhe dëshmorët e kombit, të gjithë të vrarët dhe të persektuarit, të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë ishin të mëdha, por nuk u



edhe duhej, ngaqë edhe ashtu nuk kemi territor për të humbur. Mjaft kemi humbur territor me shekuj nga luftërat e kaluar. Do të na gjykonte historia dhe brezat e ardhshëm nëse do të kishim bërë lëshime në këtë drejtim", ka theksuar Krasniqi. Ai ka thënë se Kosova ka të ardhme evropiane dhe duhet ta vazhdojë dialogun me Serbinë. "Fajtorë për çdo ngecje, moszhvillim të vendit, për mospërmbushjen e standardeve të kërkuara nga faktori ndërkombëtar, pa dyshim se janë udhëheqësit e vendit, edhe pse pasojat për këto i bartë populli i pafajshëm. Patjetër që vendi ynë duhet të ketë dhe ka një të ardhme evropiane. Dialogu duhet të vazhdojë, por jo pa u krijuar një konsensus nacional për këtë çështje", ka deklaruar Krasniqi.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, si i vlerësoni këta dhjetë vjet të shtetësisë së Kosovës? Si ishte ky rrugëtim?

Krasniqi: Për të ardhur deri te çlirimi i shtetit të Kosovës kanë punuar, luftuar dhe sakrifikuar gjenerata dhe breza të tërë atdhetarësh. Janë shumë pak për një shtet dhjetë vjet pavarësi, por për ne dhe brezat që do të vijnë, shtetësia e Kosovës, çdo minutë, çdo sekondë dhe çdo çast i saj, do të jenë lumturi dhe perspektivë.

"Epoka e re": Cilat kanë qenë të arriturat dhe dështimet e Kosovës së pavarur?

Krasniqi: Ne dolëm nga lufta, me shumë të vrarë e të plagosur, të shkatërruar fizikisht e shpirtërisht, shtëpi të djegura, ekonomi të shkatërruara, infrastrukturë të dobët, por me një vullnet të fortë për ta ndërtuar shtetin e ëndërruar me shekuj. Sukses i madh i mundshëm është vetë pavarësia e Kosovës. Janë institucionet e shtetit, njohjet ndërkombëtare etj. Ka të arritura të cilat nuk mund të mohohen, por janë shumë të vogla, duke pasur parasysh pasuritë tokësore dhe nëntokësore, resurset njerëzor dhe gatishmërinë e disave për të punuar vërtet për ndërtimin e këtij shteti.

"Epoka e re": Ndonëse vendi ynë po e bën një dekadë shtet, ende nuk është ai për të cilën është luftuar me shekuj. Madje kohët e fundit pati edhe një lëkundje të partneritetit me vendet të cilat kanë ndihmuar Kosovën në kohët më të vështira. Çfarë duhet bërë për

rrugëtimin që kemi përpara?
Krasniqi: E ceka edhe më lart, mundësitë për të qenë një shtet i ndërtuar dhe konsoliduar, për të qenë një shtet me të cilin do të krenoheshin të gjithë heronjtë dhe dëshmorët e kombit, të gjithë të vrarët dhe të persekutuarit, të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë, ishin të mëdha, por nuk u shfrytëzuan të gjitha ato, e në shumë raste edhe u keqpërdoren më së shumti nga të zgjedhurit e popullit, nga të cilët pritej edhe angazhim shumë i madh. Lëkundjet e fundit nuk kishte asnjë nevojë të ndodhnin, por edhe kjo çështje u mbyll dhe mirë u bë. Ashtu siç e kemi koordinuar rrugën deri te pavarësia, duhet ta vazhdojmë. Sigurisht na pret një punë e madhe dhe e përgjegjshme.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, edhe më tutje Kosova nuk ka arritur ta përfundojë çështjen demarkacionit me Malin e Zi. Por, këto ditë është raportuar se është gjetur një mundësi për ta mbyllur me sukses këtë punë. Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje, dhe a prisni zgjidhje të shpejtë të saj?

Krasniqi: Siç duket, më në fund edhe kjo çështje mjaft e rëndësishme për ne dhe për shtetin e Kosovës do të mbyllet ashtu siç edhe duhej, ngaqë edhe ashtu nuk kemi territor për të humbur. Mjaft kemi humbur territore me shekuj nga luftërat e kaluara. Do të na gjykonte historia dhe brezat e ardhshëm nëse do të kishim bërë lëshime në këtë drejtim.

"Epoka e re": Pavarësisht prej pritjeve, Kosova ende nuk ka fituar liberalizimin e vizave si dhe nuk ka një perspektivë të qartë evropiane, për dallim prej vendeve të tjera të rajonit, të cilave u janë përcaktuar afatet kohore për anëtarësim në Bashkimin Evropian. E vetmja gjë që i është përcaktuar vendit tonë është vazhdimi i dialogut me Serbinë. Si e shihni të ardhmen evropiane të Kosovës dhe përfundimin e dialogut me Serbinë?

Krasniqi: Fajtorë për çdo ngecje, moszhvillim të vendit, për mospërmbushjen e standardeve të kërkuara nga faktori ndërkombëtar pa dyshim se janë udhëheqësit e vendit, edhe pse pasojat për këto i bartë populli i pafajshëm. Patjetër se vendi ynë duhet të ketë dhe ka një të ardhme evropiane. Dialogu duhet të vazhdojë, por jo pa u krijuar një konsensus nacional për këtë çështje.

Rexhep Selimi: 10 vjet pengesa, pak të arritura

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, të enjten në një konferencë për medie ka folur për të arriturat dhe dështimet e Kosovës si shtet i pavarur. Ai ka thënë se Kosova këtë dhjetëvjetor po e feston me njohjen e rreth 115 vendeve, të cilat kanë ardhur kryesisht në dy vjetët e para pas shpalljes së pavarësisë. "Në këtë dhjetëvjetor kemi rreth 115 vende të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës. Nuk po them rastësisht rreth 115 për shkak se jo rralëherë është munduar ose është speculuar me këta numra. Sido që të jetë, kjo është një ndër arritjet e Republikës së Kosovës në këtë dhjetëvjetor. Në mungesë të arritjeve të tjera, si arritje kryesore duhet t'i përmendim medaljet e arta të Majlinda Kelmendit", ka deklaruar Selimi, duke shtuar se lista e dështimeve është më e gjatë. Sipas Selimit, Kosova në vend të përparimeve pati shumë stagnime. "Ngecja e parë filloi atëherë kur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës u rihapën negociatat me Serbinë dhe meqenëse Kosova ishte shpallur shtet i pavarur, sovran dhe demokratik, këto negociata e kanë kontestuar pavarësinë. Si pasojë e bisedimeve me Serbinë janë arritur shumë marrëveshje dhe kësisoj, kemi ndarjen e Kosovës në baza etnike, ndarjen e Mitrovicës edhe zyrtarisht në komunat veri dhe jug. Kemi pasur edhe ndarjen e Policisë së Kosovës në baza etnike dhe

kemi pasur pastaj një rënie drastike të dinamikës së njohjeve të pavarësisë së Kosovës. Të gjitha këto i solli rifillimi i negociatave me Serbinë", ka thënë Selimi.

Paralelisht me këtë, gjatë këtyre viteve ai ka thënë se ka ndodhur edhe një keqqeverisje, e cila ka shkaktuar korrupsion dhe krim të organizuar në Kosovë. "Kemi një rritje të papunësisë në shkallë alarmante, kemi shumë marrëveshje të dëmshme për Kosovën, siç janë marrëveshja për 'Zajednicën' dhe marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi të cilat janë shumë të dëmshme për shtetin tonë", është shprehur Selimi. Sipas tij, në fushën e dëmeve që i janë shkaktuar Kosovës gjatë këtyre dhjetë vjetëve gjithsesi është edhe Gjykata Speciale kundër UÇK-së. "Ndërsa në rrugën e integritimeve evropiane Kosova ka stagnuar dhe nuk ka arritur të bëjë as hapin e vetëm drejt këtyre integritimeve. Kosova dështoi edhe në anëtarësimin në UNESCO dhe në INTERPOL e, mbi të gjitha, kemi dështuar ta bëjmë ushtrinë e Kosovës edhe pas 10 vjetëve shtet jemi pa garantuesin e sovranitetit, ushtrinë e saj. Gjithashtu, mbesim vendi më i izoluar në Evropë", ka theksuar Selimi. Ai ka vlerësuar se pas gjithë këtyre stagnimeve përgjatë këtyre dhjetë vjetëve qytetarët e Kosovës nuk kanë se çfarë të festojnë dhe me çfarë të krenohen, pos me dështimet dhe keqqeverisjen e vendit.



Në dhjetëvjetorin e pavarësisë, Barbadosi njeh Kosovën

PRISHTINË, 15 SHKURT - Barbadosi e ka njohur Kosovën shtet të pavarur. Lajmin e ka bërë me dije ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. "Në

vigiljen e festës së madhe të pavarësisë, edhe një njohje nga shteti i Barbadosit. Urime Kosovë e dashur!", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në

"Facebook". "Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Tregtisë së Jashtme e Barbadosit i ofron komplimentet e saj Ministrisë së

Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe ka nderin t'i referohet kërkesës së mëparshme nga kjo e fundit për Qeverinë e Barbadosit për njo-

hjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, dhe për themelimin e marrëdhënieve ndërmjet Barbadosit dhe Kosovës", thuhet në letrën e njohjes.

UP-ja shënon 48-vjetorin e themelimit

Në ceremoninë e shënimit të 48-vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë marrë pjesë figura të rëndësishme të vendit, ambasadorë, rektorë, përfaqësues të AShAK-së, drejtues të UP-së, senatorë, profesorë dhe studentë. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Universiteti i Prishtinës, që mban emrin e një atdhetari dhe intelektualit të madh siç ishte Hasan Prishtina, është emblema e paqes dhe luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 SHKURT - Me rastin e shënimit të 48-vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", u vlerësuan lart roli dhe rezistenca e UP-së, në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se liria dhe shteti i Kosovës janë vlera të pandashme me Universitetin e Prishtinës. "Ky Universitet që mban emrin e një atdhetari dhe intelektualit të madh siç ishte Hasan Prishtina, është emblema e paqes dhe luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", është shprehur ai.

Presidenti Thaçi ka folur edhe për rëndësinë e këtij institucioni në kohën kur Kosova po kalon në një periudhë tjetër të rëndë-

sishme, atë të fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtarë të shtetit tonë.

Ai ka deklaruar se Universiteti i Prishtinës në historinë e tij gjysmëshekullore ka dhënë emra të paharrueshëm të dijes, shkencës si dhe ka dhënë dëshmorë të shumtë.

Rекtori i Universitetit "Hasan Prishtina", Marjan Dema, në emër të menaxhmentit, stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve, uroi 48-vjetorin e themelimit të universitetit, duke thënë se populli i Kosovës këto ditë është duke shënuar tri ngjarje madhore, 550-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dhe 48-vjetorin e themelimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Rекtori Dema ka folur për sukseset e Universitetit të Prishtinës,



rezultatet e të cilit po i tregojnë studentët e UP-së edhe në arenën ndërkombëtare dhe sukseset e stafit akademik.

Ndërsa zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Arbër Geci, ka thënë se ceremonia e themelimit të 48-vjetorit të UP-së është një moment i veçantë për ta kujtuar vullnetin, përkushtimin, sakri-

ficën dhe angazhimin e një kombi të tërë për dije dhe edukim.

Zëvendësministri Geci, në emër të ministrit Bytyqi, ka përcjellë urimet më të mira për këtë përvjetor, duke thënë se breza të tërë u flijuan për të ngritur dhe mbrojtur këtë institucion të dijes dhe shpresës. "Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte

ngjarja më e rëndësishme në sferën e edukimit dhe arsimit të popullit të Kosovës. Ky ishte momenti i kthesës për një të ardhme të ndritur për vendin tonë. Në këtë universitet u kultivuan vlera të larta kombëtare dhe buruan iniciativa që formësuan synimin e drejtë dhe historik për pavarësi të shtetit të Kosovës", ka thënë zëvendësministri Geci.

Limaj u thotë studentëve ta duan shtetin e tyre



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 15 SHKURT - Zëvendës kryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka zhvilluar të enjten një bashkëbisedim me studentët të Universitetit të Prishtinës. Gjatë këtij bashkëbisedimi studentët e kanë pyetur Limajn për çështje të ndryshme që i shqetësojnë ata, siç janë liberalizimi i vizave, hapja e vendeve të punës dhe përmirësimi i cilësisë në arsim.

Zëvendës kryeministri Limaj i ka porositur studentët të jenë pjesë aktive e shoqërisë, duke shtuar se detyra kryesore e studentëve është t'i kryejnë detyrat sa më mirë. "Duhet të

dallohet shteti nga pushteti. Nëse nuk jeni të kënaqur me drejtuesit, ndërrojeni. Por, nuk ka gjë më fisnike se me dashtë shtetin. Nuk përmbysët shteti për ta ndryshuar pushtetin. Jemi republikë parlamentare dhe shteti është i shenjtë", ka thënë zëvendës kryeministri Limaj.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, zëvendës kryeministri Limaj ka përmendur stimulimin e prodhimit vendor si mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës. Limaj ka thënë se kjo gjeneratë është me fat që jeton në kohën e pavarësisë. Pavarësia, sipas tij, ka ardhur si rezultat i mundit dhe sakrificave të shumë burra e grave ndër shekuj. Megjithatë, ka thënë se kjo nuk

është Kosova të cilën e kemi ëndërruar, por duhet të punohet më shumë nga të gjithë për të. Ndërsa dekani i Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli, ka thënë se duhet të nderohen dhe respektohen të gjithë ata që punuan për shtetin e Kosovës. "Historia na mëson se çdo përpjekjeje e vuajtjeve dhe sakrificave ka rezultuar me diçka që ne jemi mburrur. Gjatë tërë kësaj periudhe përpjekjet për liri e pavarësi nuk u ndalën për shqiptarët. Qershori i vitit '99 solli lirinë e Kosovës, e cila u pagua me shumë mund e gjak. Ne duhet të shprehim nderime për të gjithë ata studentë që ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e u vranë në beteja", ka thënë Dugolli.

OVLUÇK-ja: Komisioni mjekësor po i injoron invalidët

Prishtinë, 15 shkurt - Kryesia e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), në mbledhjen të cilën e ka mbajtur të enjten, ka diskutuar për funksionimin e komisionit mjekësor për shkallën e invaliditetit të veteranëve të UÇK-së, të cilët kanë fituar statusin e invalidit të luftës nga komisioni verifikues qeveritar.

Sipas OVLUÇK-së, komisioni mjekësor i formuar nga Qeveria më shumë është duke i injoruar veteranët - invalidë sesa që është duke ua përcaktuar shkallën që e meritojnë. OVLUÇK-ja e ka quajtur të patolerueshëm këtë gjë dhe ka paralajmëruar takim me zyrtarët qeveritarë lidhur me këtë çështje. "Duke pasur parasysh shqetësimet që na

vijnë për çdo ditë në selinë qendrore të OVLUÇK-së, konsiderojmë se komisioni mjekësor i formuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më shumë është duke i injoruar, por edhe përbuzur në mënyrë jo të dinjitetshme veteranët - invalidë sesa është duke ua përcaktuar shkallën që e meritojnë", është thënë në komunikatën e OVLUÇK-së.



Kryeministri i Malit të Zi ka përmbyllur vizitën dyditore në Kosovë

Ratifikimi i demarkacionit kërkon unitet politik


Pas vizitës së kryeministrit malazez Dushko Markoviq, disa prej liderëve institucionalë kanë bërë me dije se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi kërkon unitet politik. Sipas tyre, vetëm në këtë mënyrë mund të hapet rruga për liberalizim të vizave. Edhe njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur optimizëm se pas vizitës së kryeministrit malazez në Kosovë mund të lëvizet përpara në këtë çështje

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 SHKURT - Liderët institucionalë, pas takimeve me kryeministrin e Malit të Zi, Dushko Markoviq, kanë bërë thirrje për unitet politik rreth ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi. Ata kanë vlerësuar se të dy shtetet janë vende mike dhe duhet t'i mbyllin çështjet e hapura. Në ditën e dytë të vizitës së tij në Kosovë, kryeministri malazez Dushko Markoviq është pritur nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me të cilin ka biseduar edhe për domosdoshmërinë e ratifikimit të shpejtë të marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi për shënimin e vijës kufitare. "Ftoj për një unitet politik në Kosovë për ta ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, për t'i hapur rrugë liberalizimit të vizave. Kjo do të ishte dhurata më e bukur për qytetarët e Kosovës në këtë dhjetëvjetor të pavarësisë", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se anëtarësimi i Malit të Zi në NATO do të kontribuojë në paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Ballkan. Ndërsa kryeministri i Republikës së Malit të Zi, Dushko Markoviq, ka theksuar se Mali i Zi do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën dhe

do ta thellojë edhe më shumë bashkëpunimin ndërshtetëror. "Do të bashkëpunojmë ngushtë që t'i realizojmë interesat tona të përbashkëta, të anëtarësimit në BE", ka thënë Markoviqi. Pas takimit me presidentin, Markoviq është pritur edhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin mes dy vendeve. Sipas komunikatës për medie të Kuvendit, Veseli dhe Markoviqi kanë theksuar se Kosova dhe Mali i Zi janë shtete mike, që kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë njëra-tjetrën në integritet euroatlantike. "Në këtë drejtim të dytë theksuan gatishmërinë për ta zgjidhur me dialog çdo çështje mes palëve, përfshirë edhe demarkacionin. Kryeparlamentari Veseli theksoi nevojën që kjo marrëveshje të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës dhe që të dy vendet, Kosova dhe Mali i Zi, përveç në integritet euroatlantike, të punojnë ngushtë për forcimin e raporteve ekonomike", është thënë në komunikatën e Kuvendit të Kosovës. Kryetari i Kuvendit të Kosovës ka thënë se komuniteti shqiptar në Mal të Zi dhe ai malazez në Kosovë shërbejnë si ura të forta për avancimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve.



Njohësit e rrethanave politike, optimistë për kalimin e demarkacionit

Edhe njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur optimizëm se vizita e kryeministrit malazez mund të ndikojë në zgjidhjen e çështjes së demarkacionit me Malin e Zi. Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë për gazetën se kohët e fundit ka lëvizje pozitive në këtë drejtim edhe brenda vetë koalicionit qeverisës. "Besoj se do të mund të kontribuojë sepse në ndërkohë edhe në koalicionin aktual qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi dhe ka pasur edhe kontakte me Podgoricën që të gjendet një solution që Qeverinë aktuale dhe Haradinajn e nxjerrin 'faqebardhë'. Vizita e kryeministrit Markoviq uroj të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore me Malin e Zi", ka deklaruar Maliqi. Sipas

tij, nëse Kosova do të këmbëngulë në këtë çështje nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë të madhe të bashkësisë ndërkombëtare. "Nëse Kosova do të mbetet këmbëngulëse rreth 'humbjes së territorit' nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë bukur të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, pikërisht me vendet që kanë ndihmuar më së shumti pavarësimin dhe afirmimin e shtetit të Kosovës. Uashingtoni dhe Brukseli tërë kohën kanë pohuar se kufiri është në rregull dhe e kanë ftuar Kuvendin e Kosovës ta ratifikojë marrëveshjen. Së fundi kemi shenja të këndelljes së liderëve kokëfortë jo vetëm rreth ratifikimit të demarkacionit, por edhe rreth Gjykatës Speciale", është shprehur Maliqi. Kurse avokati i njohur Arianit Koci ka bërë me dije se demarkacioni me Malin e Zi do

të kalojë në Kuvendin e Kosovës falë kapaciteteve prej lideri që ka kryeministri Ramush Haradinaj. "Haradinaj ka kapacitet prej lideri dhe demarkacionin do ta ratifikojë. Prej Ramush Haradinajt presim vendime që janë jo të lehta, por që janë në frymën dhe orientimin e partneritetit strategjik me aleancën veriatlantike. Në fakt, Ramushi ka kapacitet prej lideri të vërtetë që temat e mëdha, duke e përfshirë demarkacionin, t'i shtyjë përpara, pa e dëmtuar Kosovën. Rrjedhimisht, edhe çështja e liberalizimit të vizave do të kalojë në fazën finale. Natyrisht, kemi fatin që kryeministri malazias, Dushko Markoviq, një prej politikanëve më të ndershëm të Ballkanit, së bashku me z. Gjokanoviq, po tregojnë vullnet që në frymën e fqinjësisë të mirë, ta zgjedhin demarkacionin. Prandaj, po, demarkacioni kalon!", ka shkruar Koci në profilin e vet në "Facebook".

Miratohet udhëzuesi i Gjykatës Supreme për politikën ndëshkimore në Kosovë

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Të enjten është mbajtur seanca e parë e përgjithshme e Gjykatës Supreme për vitin 2018, e udhëhequr nga kryetari Enver Peci, në të cilën morën pjesë, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, edhe gjyqtarët nga EULEX-i, ata nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe nga Kolegji i Apelit, i Gjykatës Supreme. Gjatë kësaj seance është shqyrtuar raporti i punës i vitit 2017, me ç'rast kryetari Peci ka prezantuar para të pranishmëve statistikat lidhur me lëndët e Gjykatës

Supreme, duke specifikuar se është bërë një punë efikase përkundër sfidave që e kanë përcjell gjykatën në vitin që shkoi. Caktimi i orarit vjetor të punës për vitin 2018 ka qenë një pikë tjetër e rendit të ditës, ndërkaq një diskutim më i gjatë është bërë gjatë shqyrtimit të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore në Kosovë, i cili është përgatitur nga ekspertë vendorë me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit. Gjyqtarët diskutuan rreth

emërimit të këtij doracaku dhe kompetencës së gjykatës për ta miratuar si produkt të saj. Shumica e gjyqtarëve u pajtuan se ky udhëzues është shumë i nevojshëm, sidomos për gjyqtarët e rinj, dhe Gjykata Supreme si institucion që unifikon praktikën gjyqësore, ka kompetencë ta miratojë këtë dokument. Gjatë diskutimit, kreu i Supremes ka bërë me dije se përmes këtij doracaku do të bëhet përpjekje që të qartësohen dispozitat e Kodit Penal rreth matjes së dënimit dhe kështu të unifikohet politika



ndëshkimore në Kosovë, pasi në praktikë janë vërejtur shqyrtime të dënimeve të ndryshme për raste të ngjashme. Ky udhëzues u

miratua me shumicë votash nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe pritet të jetë mjet punues, jooobligues për gjyqtarë dhe për prokurorë.

Veseli e Beqaj përkrahin të rinjtë

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kanë vizituar të enjten Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK), ku kanë parë punën e të rinjve që po bëjnë në fushën e inovacionit dhe teknologjisë informative.

Vizita është realizuar në kuadër të ngjarjes "Kosova Digjitale-Open Day" që është organizuar nga ICK në kuadër të shënimit të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Beqaj ka deklaruar se pasuria më e madhe e Kosovës janë të rinjtë dhe të rejtat me shkathësi të dëshmuar tashmë në fushën e tokologjisë dhe inovacionit. "Pasuria më e madhe e Kosovës janë të rinjtë dhe të rejtat të shkathëta në fushën e inovacioneve, që kanë ndikim të

drejtpërdrejtë në krijimin e ekonomisë digjitale. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do t'i përkrahë këta të rinj të cilët janë e ardhmja e vendit", ka thënë Beqaj.

Ndërsa kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka deklaruar se qëllimi i themelimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka qenë përkrahja e të rinjve me ide dhe kapacitete inovative, të cilët janë të shumta. "Qëllimi i themelimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka qenë përkrahja e të rinjve dhe të rejtave të talentuara në fushën e inovacioneve dhe teknologjisë. Ekonomia e dijes dhe ajo digjitale janë çelësat e zhvillimit. Dekada e dytë e shtetit të Kosovës do të jetë dekada e një transformimi ekonomik. Dhe këtë mund ta bëjmë më së miri me rininë tonë inovative dhe kreative", ka thënë Veseli.



MBPZhR-ja jep subvencione për disa kultura dhe veprimtari bujqësore

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka hapur periudhën e aplikimit për pagesa direkte/subvencione për disa kultura dhe veprimtari bujqësore. Për programin për pagesa direkte 2018, MBPZhR-ja ka planifikuar një buxhet prej 25 milionë eurosh dhe afati për aplikim për këtë program ka filluar nga dita e enjte dhe përfundon më 31 mars.

Ministria e Bujqësisë në programin e sivjetmë ka paraparë subvencione për grurë, për farë gruri, për misër, për elbin, për thekrën, për lulediellin, për lopë dhe buallica qumështore, për dele dhe dhi, për pulari, për bletari, për derrari, për thëllëza, për pemishtet ekzistuese, për perimet në fushë të hapur dhe në serra, për vreshtat ekzistuese, për bujqësinë organike, si dhe për fidane të pemëve drufrutore dhe



hardhi të rrushit. Po ashtu, subvencionim do të ketë edhe për akuakulturën, therjet e raportuara të gjedhit, për qumështin

sipas kategorive të cilësisë dhe për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht. Në programin për pagesa direkte

të këtij viti, është rritur përkrahja për kulturën e elbit dhe thekrës, ku nga 100 euro sa ishte vitin e kaluar, sivjet kjo mbështetje është

bërë 150 euro për hektarë të mbjellë. Po ashtu, te sektori i hortikulturës, nënsektori i vreshtarisë sivjet nuk do të ketë përshkallëzim të përkrahjes, por do të përkrahen të gjithë fermerët që kanë të mbjellë rrush me sipërfaqe prej së paku 0.10 hektarësh, në vlerë prej 1 000 eurosh për hektar.

Ndërsa kultivuesit e perimeve sivjet, përveç mbështetjes për kultivimin e këtyre kulturave në fushë të hapur, do të mbështeten edhe për kultivimin në serra. Risi tjetër për programin e këtij viti është edhe rritja e përkrahjes për bujqësinë organike, ku nga 300 euro sa ishte vitin e kaluar, sivjet kjo mbështetje është bërë 500 euro për hektar. Krahas kësaj, ka risi edhe në sektorin e blegtorisë, tek therjet e raportuara të gjedhit, ku sivjet, përveç kategorisë A dhe B, përmes pagesave direkte do të përkrahen edhe kategoritë C dhe D.

Ministri Lluka premtan mbështetje për projektet e Komunës së Pejës dhe të Istogut

PEJË, 15 SHKURT (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka vizituar të enjten Pejën dhe Istogun. Ministri Lluka gjatë takimit me kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka folur rreth projekteve në sektorin e ujit, respektivisht ujësjellësit, për trajtimin e ujërave të zeza, për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave etj. Në këtë takim theks i veçantë i është dhënë realizimit të projektit për furnizim me

ujë të fshatrave të Lugut të Baranit, pastaj gjetjes së zgjidhjeve për fshatrat e Rugovës, duke pasur parasysh se furnizimi me ujë do të ketë ndikim edhe në zhvillimin e turizmit.

Ministri Lluka ka vizituar edhe KRU "Hidro Drini", ku është pritur nga bordi dhe menaxhmenti i kompanisë, me të cilët ka diskutuar për planet dhe sfidat e kësaj kompanie. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka vizituar edhe Komunën e Istogut. Ai ka takuar disa nga anëtarët e Shoqatës për Prodhimin e Peshkut, të cilët kanë ngrehur shqetësimin për mënyrën e faturimit dhe të pagesave që u ngarkohen për shfrytëzimin e ujit nga kompania "Drini i Bardhë".

Ministri Lluka u ka premtuar atyre se do të angazhohet, në kuadër të përgjegjësisë që ka, por edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera, që ky problem të zgjidhet.



Kosova përfiton 38.5 milionë euro për rehabilitimin e hekurudhave



Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor ka ndarë për Kosovën 38.5 milionë euro për projektin për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 të Kosovës. Ky projekt do të realizohet me mbështetje të Bashkimit Evropian, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Investive Evropiane

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor ka ndarë për Kosovën 38.5 milionë euro për projektin për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 të Kosovës, i cili projekt do të realizohet me mbështetje të Bashkimit Evropian, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Investive Evropiane. Marrëveshja për projektin për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 të Kosovës është nënshkruar të enjten ndërmjet Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila

do ta zbatojë grantin e Kornizës për Investimeve për Ballkanin Perëndimor. "Financimi i ndërtimit të linjës kryesore hekurudhore, e cila na lidh në të dy drejtimet me Bashkimin Evropian, do të realizohet me mbështetje të Bashkimit Evropian, BERZh-it dhe Bankës Investive Evropiane dhe kapë vlerën prej 195.5 milionë eurosh dhe do të realizohet në tri faza. Faza e parë e projektit, e cila pritet ta fillojë ndërtimin sivjet, përshkon 64 kilometra nga Hani i Elezit deri në Fushë-Kosovë. Bashkimi Evropian do të financojë 38.5 milionë euro me donacion, BERZh-i dhe Banka Investive Evropiane me nga 19.2 milionë euro kredi. Ndërsa për

fazën e dytë, e cila përshkon linjën nga Fushë-Kosova deri në Mitrovicë me 35 kilometra, nga BE-ja janë ndarë mjete në vlerë prej 17.2 milionë eurosh për punët fizike dhe për këtë do të nënshkruajmë marrëveshje në muajt në vijim", ka bërë me dije ministri i Financave, Bedri Hamza.

Ai ka shtuar se Ministria e Financave bashkë me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Ministrinë e Linjës përmes Këshillit Kombëtar të Investimeve do të aplikojnë për financimin e fazës së tretë, e cila përshkon segmentin prej 42 kilometrave nga Mitrovica deri në kufi me Serbinë. "Vlera që do ta kërkojmë për fazën e tretë pritet ta kapë vlerën mbi 24 milionë euro. Për realizimin e këtij projekti janë përfshirë shumë institucione. Duhet t'i falënderoj të gjitha institucionet për punën që kanë bërë, veçanërisht t'i falënderoj taksapaguesit evropianë për mbështetjen për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit tonë", ka deklaruar ministri Hamza.

Ndërsa drejtori i Komisionit Evropian për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Christian Danielsson, duke e vlerësuar lart rëndësinë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ka theksuar se kjo hekurudhë i mundëson Kosovës të lidhet me vendet fqinje dhe Bashkimin Evropian. "Kjo hekurudhë lidh Kosovën me vendet fqinje dhe për këtë sot kemi nënshkruar një kontratë që ka të bëjë me ndërlidhshmërinë e hekurudhës nga Prishtina në jug. Është pjesa e ndërlidhmërisë me Ballkanin Perëndimor. Në momentin kur kjo linjë të jetë e instaluar do të lejojë lidhje më të mirë dhe mundësi të mira për njerëzit për t'i mbajtur kontaktet", ka thënë Danielsson.

Kurse drejtoresha menaxhuese për Evropën Qendrore dhe Juglindore e BERZh-it, Charlotte Ruhe, ka thënë se kjo marrëveshjeje ka thelluar bashkëpunimin me Kosovën, me donatorët dhe BERZh-in. Ajo ka bërë me dije se do të vazhdohet edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera.

"Modernizimi i infrastrukturës së transportit është një nga prioritetet kryesore të BERZh-it në Ballkanin Perëndimor, duke ndihmuar në përmirësimin e rrugëve tregtare brenda rajonit, për ndërtimin e ekonomive të integruara dhe për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe për përmirësimin e jetës së njerëzve në Kosovë duke ofruar lidhje më të mirë me rajonin dhe Evropën gjerësisht", ka thënë Ruhe.

Ndërsa ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka theksuar rëndësinë e kësaj linje hekurudhore jo vetëm si moment i ri i marrëdhënieve BE - Kosovë, por edhe leverdinë ekonomike që do të sjellë hekurudha.

Projekti hekurudhor 10 i Kosovës është pjesë e rrjetit hekurudhor kryesor të Ballkanit Perëndimor, një zgjerim i Rrjetit Trans-Evropian të Transportit, e cila është pjesë e përpjekjeve më të gjera të BE-së për ta promovuar lidhjen e transportit në Ballkanin Perëndimor.

Ministri Rikalo: Prioritet yni, kultivimi i produkteve pyjore jodrusore

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në Panairin Ndërkombëtar të Ushqimit Organik "Biofach", i cili po mbahet në Nuremberg të Gjermanisë, është duke marrë pjesë edhe ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo. Ai ka thënë se kompanitë e Kosovës po bëjnë prezantim dinjitoz të produkteve. Ai ka theksuar se

Ministria e Bujqësisë do të fokusohet për rritjen e kapaciteteve të kompanive që merren me kultivimin e produkteve pyjore jodrusore dhe bimëve aromatike mjekësore. Në këtë kontekst, Rikalo ka thënë se zhvillimi i këtij sektori do të jetë prioritet në katër vjetet e ardhshëm. Ai ka thënë se MBPZhR-ja do ta mbështesë

organizatën "Organika" për organizimin e panairëve të tilla, në të cilat agrobizneset vendore do të mund ta bëjnë promovimin e kulturave bujqësore.

Ndërkaq drejtori ekzekutiv i Shoqatës "Organika", Faton Nagavci, ka thënë se Kosova, edhe pse mund të jetë prodhuese më e vogël se shumë

shtete të tjera në sektorin e ushqimit organik, cilësia e lartë e produkteve të certifikuara që dorëzohen me kohë mundëson kërkesë më të madhe për këto produkte në tregun vendor e të huaj.

Panairi "Biofach" do të jetë i hapur deri më 17 shkurt. Në këtë panair janë duke marrë pjesë shumë shtete nga e mbarë



e bota, ndërkaq Kosova po prezantohet me katër kompani prodhuese dhe përpunuese të produkteve pyjore jodrusore dhe të bimëve mjekësore aromatike.

Një deçenie pavarësi e sovranitetit



Salihe SALIHU -
PhD kandidat

Kosova pas çlirimit nga okupimi serb në vitin 1999 nuk arriti që menjëherë prej atij momenti ta gëzojë pavarësinë dhe ta shtrijë sovranitetin. Normat e fabrikuarat ndërkombe-tare e ndaluan ecurinë e Kosovës për procesin më dinamik drejt pavarësisë dhe sovranitetit. Ky lloj prolongimi ishte arsyetuar me aspiratën e ndërkombe-tarëve që të arrihet paqja para pavarësisë dhe sovranitetit. Me këtë rezonim të faktorit ndërkombe-tar u pajtua edhe faktori i brendshëm dhe veprimi konform marrëveshjes me ndërkombe-tarët, që të kontribuojë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Por, pavarësia dhe sovraniteti ishin elementë kyç që Kosova të bëhej një shtet karshi shteteve të tjera të botës. Prandaj, angazhimet e panumërta të aktorëve politikë për ta kurorëzuar e finalizuar statusin e Kosovës u zhvillua me negociata të ndërlikuara gjatë periudhës prej pasluftes deri te Dita e Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008.

Pavarësia e legjitimuar

17 shkurti 2008 ishte data për të cilën ishin sakrifikuar shumë breza dhe tani sakrificat e tyre u hynjësua në Pavarësi. Me shikim drejtuar në këtë manifestim hynjorë lirshëm mund të konstatohet se kjo ishte Dita më madhështore që po e festonin shqiptarët që prej 1912-s. Gjaku i heronjve, dëshmorëve e martirëve ishte në gurë themelin e Momentumit të ri. Pavarësia e Kosovës u bë një faktum, një realitet i ri duke e shpallur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur e sovran. Pavarësinë e Republikës së Kosovës e mbështeten shtetet më të fuqishme Perëndimore duke e njohur si shtet të pavarur dhe sovran. Me këto njohje Republika e Kosovës fitoj legjitimitetin ndërkombe-tar.

Republika e Kosovës si shteti i ri mori përsipër që me një qeverisje të butë por të drejt ta fuqizon performancën e vet shtetërore si brenda vendit edhe jashtë saj. Në raportin e brendshëm qeverisja vendore bëri hapa zhvillimor që të përmirëson jetën e qytetarëve të vet. Mirëpo ndryshim dhe përmirësim nuk arrihen me minutazhat e orëve apo ditëve por kërkohet kohë që të formohet dhe zhvillohet së pari mentaliteti i të bërit shtet, që në radhë të parë të mendohet që shteti të ruhet e te mbrohet. Ky zhvillim i mendësisë është primarë për

qëndrueshmërinë e një shteti të pavarur e sovran. Kur në mendjen e secilit ngulitet se pa një shtet të fuqishëm nuk mund të mbrohet as familja e shoqëria por as prona shoqërore e private atëherë mund të themi se duam shtetin. Kur shteti është me prioritet numër një në mendësinë e çdo qytetari atëherë s'ka forcë që mund ta mposhte ekzistencën e tij. Pas këtij formimi në kokën e secilit mund të mendojmë për zhvillimin e mëtutjeshëm të shtetit. Vetëkuptohet se zhvillimi shoqëror kalon nëpër procese dhe se çdo proces ka ecurit e veta dhe duhet të merret parasysh që procesi zhvillimor përbëhet nga nuancat specifike.

Në vëzhgim të këtyre nuancave në shtetin tonë mund të themi se hapat zhvillimor janë të matshëm por jo të kënaqshëm apo të përmëshur. Zhvillimi ekonomik nuk është i nivelit të dëshirueshëm apo që mund të mburremi se i plotësoj aspiratat as të qeveritarëve por as të popullit. Ngecjet e pakontrolluara shkaktuan një lloj dëshpërimit por fatbardhësisht nuk shkaktuan ndonjë kolaps në zhvillimin shoqëror të vendit. Kjo gjendje duhet që sa ma parë të përmirësohet. Fatmirësisht orvatjet për të hap perspektivën ekonomike me ritëm më të theksuar po vazhdojnë ndonëse këto premtime të udhëheqësve janë ende në formë deklarative megjithëkëtë kjo çështje mbetet në fazën e pritshmërive.

Sovraniteti

Në raportin ndërkombe-tar Republika e Kosovës ka një progres të kapshëm përmes anëtarësimit në disa instanca ndërkombe-tare dhe vazhdon me përgatitë terrenin për aplikime të reja për t'u anëtarësuar në më shumë instanca tjera ndërkombe-tare.

Por në këtë vit jubilar, 10-vjetori i pavarësisë dhe vit i Skënderbeut, duhet të jetë vit i Kosovës evropiane. Kosova duhet të rrisë aktivitetin e saj për integrim në Unionin Evropian. Gjithë liderët shqiptarë të përpiqen që në koordinim me njëri tjetrin të prezantojnë platformën politike në raport me ndërkombe-tarët për vitin 2018 - të shpallin vitin 2018 si vit jubilar për anëtarësim si simbolik e 100-vjetorin të përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe të bëhet trysni për të mundësuar shansin për pakon e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor.

Me një angazhim të gjithanshëm të gjitha përfaqësuesit e Kosovës të agjitojnë në vende ku ata përfaqësojnë Kosovën që ky rast të mos humbet sikurse që u humb rasti i propozuar në Samitin e Selanikut që parashikonte që viti 2014 të ishte vit i anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor. Ky argument para ndërkombe-tarëve do lëvizë gurët për të mundësuar rrjed-

hën e procesit.

Përkundër turbulencave të herëpashershme, Republika e Kosovës përballoi çdo stuhë. Në shënimin e një deçenie pavarësi dhe sovranitet, Republika e Kosovës, duke qeverisur me parimin e organizimit të lirisë dhe vetëpërmbytjes, ka arritur të gjenerojë një bashkëjetesë të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Gjithashtu, ka përmirësuar bashkërendimin për një qeverisje të përbashkët që si moto ka për të mirën e përbashkët për të gjithë qytetarët.

Republika e Kosovës sovranë është dëshmuar se ka kapacitete ta mbrojë territorin e saj nga çdo lloj tendencë shkatërrimtare qoftë nga aktorë të brendshme apo të jashtëm. Gjatë një deçenie pavarësi Republika e Kosovës sovranë sfidoi planifikimin e aktit terrorist në Prishtinë si dhe parandaloi sulmin pompoz përmes vijës hekurudhore.

Sovraniteti i Republikës së Kosovës ka nevojë për secilin qytetar sepse secili nga ne është sovran dhe me bashkimin e sovranitetit individual kemi unifikuar sovranitetin shtetëror. Me këtë formulë Republika e Kosovës ka rritur fuqinë e shtetit dhe ka kontinuitet për progres për të ardhmen. Në gjithë botën Republika e Kosovës, me arritjet e veta gjatë një deçenie pavarësi e sovranitet, është një dëshmi e një storie të suksesit të shtetit më të ri në Evropë.

Aktakuzë ndaj dy të dyshuarve që planifikonin sulm vetëvrasës në Kosovë

PEJË, 15 SHKURT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër dy personave për kryerjen e veprave penale moslajmërimi i veprës penale dhe shtytje për kryerjen e akteve terroriste.

Në aktakuzë, që është ngritur në Gjykatën Themelore të Pejës, thuhet se dy të dyshuarit kanë bashkëvepruar për një kohë të gjatë. "Sipas aktakuzës, R. A. në vazhdimësi në mënyra të ndryshme ka postuar mesazhe për publikun, me qëllim që ta shtyjë kryerjen e aktit terrorist, në atë mënyrë që në rrjetin social 'Facebook', në profilin e tij, ka postuar video-incizime, fotografi dhe komente, duke shprehur haptazi përkrahjen

dhe simpatinë ndaj organizatës terroriste Shteti Islamik", thuhet në komunikatën e Prokurorisë.

Po ashtu, i dyshuari R. A. i ka kërkuar të dyshuarit tjetër K. P. të kryejë një sulm vetëvrasës në territorin e Republikës së Kosovës. Të dyshuarit ishin në kërkim për të gjetur të holla "për financim dhe disa vëllezër myslimanë për të organizuar një sulm vetëvrasës kundër shtetit, kundër Qeverisë", thuhet në aktakuzë.

Sipas aktakuzës, të dyshuarit kanë pasur kontakte gjatë vitit 2017 me persona që kanë marrë pjesë në luftën e Sirisë dhe të cilët dyshohen se janë marrë me aktivitetet terroriste.

Agim Aliu mban zotimin për realizimin e platformës ekonomike

Ferizaj, 15 shkurt - Këshilli ndërdrejtorial në Komunën e Ferizajt ka mbajtur mbledhjen e parë, në të cilën është diskutuar për hapat që do të ndërmerren nga ky mekanizëm për hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike.

Misioni i këtij mekanizmi institucional është të propozojë dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e platformës ekonomike të kryetarit Agim Aliu.

Këshilli ndërdrejtorial përbëhet nga drejtorët e Drejtorisë së Financave, asaj të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Drejtorisë së Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrës, asaj të Infrastrukturas, ndërsa kordinator i këtij këshilli është caktuar zëvendësiministri i



Financave, njëherësh këshilltar i kryetarit Agim Aliu për zhvillim ekonomik, Mustafa Grainca.

Ky mekanizëm paraqet një zotim të përmëshur të kryetarit Agim Aliu për qeveris-

jen e konsultuar me profesionistë dhe ndërveprimin në mes të drejtorive komunale për aplikimin e politikave ekonomike komunale të cilat do ta nxisin zhvillimin ekonomik lokal.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (7)

ADEM DEMAÇI DO TË JETË HERO I KOSOVËS



Selatin NOVOSELLA

137. Jetlir Zyberaj, gazetar: 53 njohjet e para të pranimit të pavarësisë së Kosovës, Adem Demaçi i vlerëson si themel i shtetësisë së Kosovës

Simboli i rezistencës kombëtare shqiptare, Adem Demaçi, vitin 2008 e ka cilësuar vit të suksesit të madh për Kosovën, për faktin se këtë vit u shpall pavarësia e saj, e cila është njohur nga 53 shtetet kryesore të botës. Adem Demaçi këto njohje i vlerëson si themel të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

138. Jonuz Fetahaj, shkrimtar: Adem Demaçi eci ballëhapur kah ardhmëria

Adem Demaçi me stoicizmin e tij diti të ec ballëhapur kah ardhmëria tok me popullin e vet. Prandaj, emri dhe mbiemri i tij gjithmonë do të shkruhen me shkronja të Mëdha dhe kurrë fjalia e tij nuk mund të ketë pikë e presë, sepse shenjat e Pikësimit për këtë Kolos të kombit kurrë nuk kanë ekzistuar në Gramatikën e Jetës së tij...

139. Jusuf Buxhovi, historian: Adem Demaçi nga irredentisti tek militanti i pavarësisë së Kosovës Në galerinë e figurave të rëndësishme të lëvizjes kombëtare të Kosovës për çlirim nga pushtuesit serbo-jugosllav, Adem Demaçi, mbetet i veçantë për faktin se në të shfaqet si irredentist për të përfunduar si militant i pavarësisë së Kosovës.

140. Jusuf Gërvalla, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, shkrimtar i terrorizuar

Një fat të vështirë, për të qenë i terrorizuar edhe fizikisht, por edhe për të rënë në harresë si shkrimtar, e ka pasur hise patrioti dhe revolucionari i madh shqiptar në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore - Adem Demaçi.

141. Kadri Kryeziu, njëri prej organizatorëve të demonstratave të vitit 1981: Adem Demaçi, frymëzues i përhershëm i lëvizjes kombëtare Sikurse më 1974, ashtu edhe në vitin 1978, ka pasur shumë njerëz tanë në burgjet jugosllave, që burgoseshin vetëm pse e nginin zërin kundër padrejtësive, në mesin e të cilëve ishte edhe frymëzuesi i përhershëm i lëvizjes politike dhe kombëtare në Kosovë, Adem Demaçi.

142. Kadri Rexhaj, veprimtar i çështjes kombëtare: Drama "Politika dhe pushka" e Adem Demaçit është vepra më autobiografike e Demaçit Drama "Politika dhe pushka" e

shkrimtarit Adem Demaçi është veprë e veçantë e letërsisë shqipe. Nëse jo kryevepër, në saje të temës, idesë, porosisë dhe vlerave letrare, padyshim, kjo dramë do të mbetet vepra më autobiografike dhe më e çmuar e autorit të saj.

143. Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës: Adem Demaçi do të jetë hero i Kosovës deri sa të ekzistojë Kosova

Në Republikën e Kosovës çmimin më të lartë për vepra sakrifice dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës e kemi dekoratën Hero i Kosovës. Baca Adem Demaçi këtë titull e mori, formalisht, në vitin 2010, por, ky titull i takoi që nga dita e parë e arrestimit të tij, më 19 nëntor 1958. Ai, që nga kjo ditë, vijon të jetë Hero i Kosovës. I tillë do të jetë, deri sa të ekzistojë Kosova!

144. Kadrush Radogoshi, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës: Duke e nderuar Adem Demaçin Qeveria e Kosovës ajo e nderon vetveten

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'i dhënë Adem Demaçit Pension Kombëtarë është vendim i cili, në radhë të parë, nderon Qeverinë e Kosovës. Po ashtu, me këtë vendim, janë nderuar të gjithë të burgosurit politikë të Kosovës.

145. Kofi Anan, sekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara: Shqiptarët duhet të jenë krenarë me Adem Demaçin

146. Kosovare Krasniqi, punëtoreshë shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi, udhërrëfyes për popullin shqiptar

Adem Demaçi me fuqinë e fjalës dhe me qëndrimin e tij prej titani nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, për popullin shqiptar u bë zë i guximit, zë i shpërësës, zë i forcës, zë i besnikërisë. Vetë emri dhe qenia e tij i reflektonin të gjitha këto. Ai, duke u sakrifikuar, u kthye në simbol të udhërrëfyesit për popullin e tij.

147. Kristina Rasi, gazetare: Adem Demaçi: "Unë do t'i thosha Adem Jasharit "BAC, U NIS!"

Në një intervistë për revistën "Shqipëria sot", të 8 marsit 2008, të Tiranës, Adem Demaçi ka thënë se shpallja e pavarësisë është vetëm fillimi i pavarësisë së vërtetë të Kosovës. Për sloganin "BAC, U KRY"! Demaçi ka thënë se slogan i objektiv do të duhej të ishte: "BAC, U NIS!"

148. Kudusi Lama, gjeneral i Ushtrisë Shqiptare: Adem Demaçi, argumentues i të ardhmes kombëtare shqiptare

Adem Demaçi me jetën e tij nuk ka qenë vetëm një qëndrestar përballë pushtuesit, por edhe një arsytues dhe argumentues i të ardhmes kombëtare shqiptare, duke interpretuar gjithnjë me fuqinë e fjalës e të mendimit, të ardhmen e shqiptarëve, përtej pushtimit e edhe përtej jetës së Adem Demaçit.

149. Latif Gashi, komandant në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi, Abetare ku mëso-

hej udha e lirisë

Adem Demaçi, me shembullin e tij, me rrugëtimin e tij të gjatë drejtë Lirisë, rrugëtim i vështirë dhe plotë fljime, do të shndërrohet në Abetare ku mësohej udha që shpinte tek Liria kombëtare. UÇK-ja, në realitet, është vazhdimësi e të gjitha aktiviteteve ilegale të udhëhequra nga veprimtarë të mëdhenj të Çështjes kombëtare, e që u inspiruan nga simboli dhe ideatori i kësaj lëvizjeje, Adem Demaçi.

150. Lazar Stojanović, bashkëvuajtës i Adem Demaçit në Burgun e Pozharevcit: Adem Demaçi është luftëtar i pathyeshëm Demaçi nuk është Mendela jugosllav vetëm me gjatësinë e burgut të tij, por, para së gjithash, me qëndrimin e pakopromis dhe me moralin e lartë të luftëtarit të pathyeshëm.

151. Lebit Murtishi, shkrimtar: Më



dhet shpirti dhe zemra e Adem Demaçit

Sa herë mendohej të hedh mbi supë vetëm një vit nga vitet e Adem Demaçit, më duket se për ta shpënë në cak më duhet të marr hua pak fuqi nga fuqia e tij; më duhet mendja dhe guximi i tij; më duhet shpirti dhe zemra e tij.

152. Lindita Nikolla, ministre e Arsimit në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë:

Nderimi i Adem Demaçit është reflektim për historinë tonë kombëtare

Sot, në Universitetin e Tetovës, kur po nderojmë Adem Demaçin me titullin "Doktor Nderi i Universitetit të Tetovës", nuk po nderojmë vetëm Adem Demaçin, sot po nderojmë, po ndihemi krenar dhe po reflektojmë për historinë tonë, historinë e fundshekullit të kaluar dhe fillimit të shekullit të ri.

153. Lirim Geci, gazetar: Mbledhja e përbashkët e qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës është një lloj bashkimi kombëtar

Nderi i Kombit dhe Heroi i Kosovës, Adem Demaçi, duke folur për mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Shqipërisë dhe të Kosovës, e cila do të bahet në Prizren, më 11 janar 2014, përveç tjerash, tha: "Mbledhja e tillë e dy Qeverive tona është një lloj bashkimi kombëtar, duke pasur parasysh kohën dhe hapësirën në të cilën po jetojmë si dhe trendet ndërkombëtare në të cilat jemi

duke shkuar".

154. Luëzim Etemaj, publicist: Porosia e njohur e Adem Demaçit në romanin e tij të parë, është porosi e projektit të tij kombëtar Mesazhi i romanit të Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut": Jo - atyre që janë trima të ngrenë gishtin e kimit! Por - atyre që janë trima të shtrijnë dorën e pajtimit" dhe Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë 1990 - 1991, është njëri nga kapitujt më rëndësi të veçantë të projektit shqiptar, jo vetëm të Kosovës por edhe përgjithësisht të atyre që jetojnë jashtë shtetit amë - Shqipërisë.

155. Matjash Hanzhek, publicist: Adem Demaçi e njeherë bota Për njeriun, si Adem Demaçi, që në mesin e njerëzve jeton si legjendë, qarkullojnë tregime të llojllojshëm, të vërteta dhe më pak të vërteta. Imagjinata e njeriut është e pamatur, posaçërisht kur është fjala për njeriun, të cilin e njeherë bota. Njerëzit, nëpërmes bisedimeve i afrohen heroit të tyre dhe me të identifikohen.

156. Medlin Olbrajt, sekretare e Shtetit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës: Adem Demaçi nuk pajtohej me gjithçka për Kosovën Adem Demaçi ishte një nacionalist i vjetër kosovar, njëri prej atyre që i bënin presion Thaçit të ruante qëndrimin më të ashpër të mundshëm. I telefonova në Slloveni, ku ndodhej, dhe i kërkova ta nxiste Thaçin që të mbështeste qëndrimin tonë. Demaçi u përgjigj se nuk mund të pajtohej me gjithçka... I thash Demaçit: Ka dy javë që palët po bisedojnë. Edhe fare pak orë kanë mbetur që të skadojë afati i fundit. Mund të takohemi me ju në të ardhmen, por tani ju duhet t'i jepni Thaçit miratimin tuaj. Në rast se nuk e bëni këtë, dështimi do t'ju ndjek si hije gjatë gjithë kohës që shqiptarët e thjeshtë do të vriten. Demaçi tha: Ne i çmojmë përpjekjet tuaja, po nuk duam të nxitohe mi. Nëse është e nevojshme të vdesin edhe tridhjetë mijë shqiptarë, le të vdesin, por ne nuk do t'i dorëzojmë armët vetëm mbi bazën e premtimeve. Ne nuk do të heqim kurrë dorë nga ëndrra jonë për të qenë të lirë. Iu përgjigja: Propozimi im nuk do të thotë që të hiqni dorë nga ëndrra juaj. Mos e lini t'ju ikë nga dora ky shans për paqe. Thoni Thaçit se e mbështetni atë. Demaçi ma priti: Është e pamundur. E mbylla telefonin me një ndjenjë pështirosjeje. Kjo bisedë telefonike kishte qenë për mua një nga bisedimet më rrëqethëse që kisha pasur ndonjëherë në jetën time.

157. Mehmet Emërllahu, gazetar: Adem Demaçi, edhe pas 28 viteve të burgut, vazhdoi angazhimet për pavarësinë e Kosovës Adem Demaçi 28 vjet qëndroi në burgjet e ish-Jugosllavisë për pavarësinë e Kosovës dhe pasi doli nga burgjet, në vitin 1990, e gjeti të okupuar nga i njëjti pushtues - Serbinë. Adem Demaçi sërish vazhdoi të angazhohet për

pavarësinë e Republikës së Kosovës.

158. Mehmet Hajrizi, njëri nga pjesëmarrësit e Konferencës së Rambujes në vitin 1999: Po të dëshironte Adem Demaçi do të bëhej president

Po të dëshironte Adem Demaçi të bëhej president ose ta synonin këtë të burgosurit politikë të Kosovës, në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Kosovë, në qershor të vitit 1992, ai mund të kandidohej dhe, pa dyshim, do të fitonte.

159. Mehmetali Rexhepi, shkrimtar: Adem Demaçi shtroi si kryeçështje çlirimin e Kosovës

Diskursi i Adem Demaçit nuk ishte thjeshtë një vetëmbrojtje individuale. Ai diskurs shpaloi përmasën madhore të çlirimit e të bashkimit të shqiptarëve, si një domosdoshmëri, që duhej të merete shtrirje e të drejtën e qytetarisë, të mos mbetet çështje individësh a grupesh "të frustruara", por të shtrohej si kryeçështje jetike, madje programatike për të gjitha brezat e shqiptarëve.

160. Memli Krasniqi, punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi, frymëzues për veprime atdhetare

Në vitin 1975, kur Josip Broz Tito po e vizitonte për herë të tretë Kosovën, ishte marrë vendimi për burgosjen e tretë të frymëzuesit për veprime atdhetare. Cili mund të ishte frymëzuesi i tillë i mundshëm? Natyrisht, Adem Demaçi, ikona e nacionalizmit lirinëshëm shqiptar. Dhe si çdo elitë në pushtet ashtu edhe ajo kosovare do të mendohej të eliminonte një rrezik të tillë qoftë ai edhe imagjinar.

161. Meriman Braha, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare: Veprimtaria atdhetare Adem Demaçit do t'i sigurojë pavdekësinë Veprimtaria atdhetare Adem Demaçit do t'i marrë pjesën më të mirë të jetës, por që do t'i sigurojë pavdekësinë, oreolin e Heroit, të Nderit të Kombit, që do të kalojë kufijtë kombëtarë dhe do të bëhet idhull i brezave të rinj.

162. Mero Baze, gazetar: Adem Demaçi, lider politik i shqiptarëve të Kosovës

Adem Demaçi, i cili zëvendësoi Bajram Kosumin në postin e kryetarit të Partisë Parlamentare të Kosovës, filloi një ofensivë të ashpër ndaj kryetarit Rugova. Për këtë e ndihmoi dhe një vizitë e tij në Shqipëri, disa intervista në televizionin zyrtar të Tiranës dhe promovimi si lider gjatë takimeve me partitë politike në Tiranë.

163. Merxhan Avdyli, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi nuk ka as paraardhës as pasardhës Shumë personalitete shqiptare mund ta kenë dytësorin e tyre, paraardhës apo pasardhës, si ky apo si ai, por Demaçi, është një prej të rrallëve, që nuk është as si ky e as si ai. Ai është vetëm Adem Demaçi.

(Vijon)

Stoltenbergu: Takim me Lavrovin në periudhën e "tensioneve të larta"

BRUKSEL, 15 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se pret të takohet me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov, javën e ardhshme gjatë Konferencës së Sigurisë në Muni, duke u shprehur se "dialogu është veçanërisht i rëndësishëm kur tensionet janë të larta". "Kjo është pjesë e dialogut tonë poli-

tik me Rusinë. Ne do të diskutojmë shumë çështje të ndryshme, por pres, po ashtu, të shqyrtojmë se si të jemi të sigurt se Këshilli NATO-Rusi mund të vazhdojë të mbetet platformë për dialog ndërmjet NATO-s dhe Rusisë. Besoj se dialogu është gjithnjë i rëndësishëm, por dialogu është veçanërisht i rëndësishëm kur

tensionet janë të larta dhe marrëdhëniet janë të vështira, ashtu siç janë tash", tha të enjten Jens Stoltenberg, pas ditës së dytë të takimit të ministrave të mbrojtjes së vendeve të NATO-s në Bruksel. Konferenca e Sigurisë në Muni, e cila tradicionalisht organizohet çdo vit, mbahet më 16 dhe 17 shkurt.



Senati amerikan debaton për reformën e imigracionit

Ligjvënësit amerikanë thanë se kërkojnë të gjejnë një zgjidhje për të ashtuquajturit "Ëndërrimtarë" deri në fund të javës, por ende kanë mosmarrëveshje

UASHINGTON, 15 SHKURT - Senati amerikan filloi debatin për një numër propozimesh për imigracionin, por nuk u duk të jetë afër një zgjidhjeje për 1.8 milion imigrantët e rinj pa dokumente që janë sjellë në Shtetet e Bashkuara qysh fëmijë. Me skadimin e afatit më 5 mars për përfutjesit e programit DACA dhe me premtimin e drejtuesit të shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell për ta mbajtur hapur debatin për emigracionin për një kohë të kufizuar, duket se koha po mbaron me shpejtësi.



Ligjvënësit thanë se kërkojnë të gjejnë një zgjidhje për të ashtuquajturit "Ëndërrimtarë" deri në fund të javës, por ende kanë mosmarrëveshje. "Logjika të thotë se nuk mund të trajtohet një simptomë të politikës sonë të dështuar të imigracionit. Ne duhet t'i trajtojmë problemet themelore. Kjo do të thotë ndreqja e sistemit tonë ligjor të imigracionit", tha udhëheqësi i shumicës republikane në senat, Mitch McConnell.

Senati ka përpara një mori projektligjesh mbi sigurimin e kufirit, verifikimin e punësimit dhe ndryshime madhore të numrit të migrantëve në këmbim të një zgjidhjeje për programin DACA - për të cilat demokratët thonë se duhet zgjidhur në një kohë tjetër. "Këtë javë, nuk jemi këtu për të debatuar për një reformë

bashkëkohore të imigracionit. Nuk jemi këtu për të debatuar se si kryetarët e bashkive drejtojnë qytetet e tyre apo sesi e bëjnë punën oficerët e policisë. Jemi këtu për të mbrojtur "Ëndërrimtarët". Jemi këtu për të zgjidhur një krizë që presidenti Trump e filloi shtatorin e kaluar kur i dha fund programit DACA", tha senatori demokrat Robert Menendez.

Por nëse përfutjesit e programit DACA sigurojnë një rrugë drejt shtetësisë, republikanët duan që niveli i imigracionit të balancohet në fusha të tjera. "Kemi një sistem imigracioni ku gati 75% e atyre që vijnë në këtë vend vijnë vetëm pasi kanë lidhje familjare. Tani për tani është thjesht një për zgjedhje e rastësishme që nuk lidhet me nevojat tona ekonomike dhe nuk ka të bëjë me rritjen apo sigurinë tonë ekonomike", thotë senatori

republikan Thom Tillis. "Ne nuk do të lejojmë "Ëndërrimtarët" të mbahen peng i axhendës së imigracionit të Trumpit", tha senatori demokrat, Dick Durbin. Negociatat për një projektligj specifik që mbron "Ëndërrimtarët" në këmbim të sigurisë së kufirit, mund të jenë e vetmja rrugë përpara. "Pyetja shtrohet në se siguron 60 vota në Senat, cili do të jetë fati i projektligjit kur të shkojë në Dhomën e Përfaqësuesve? Shanset që shumica e anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve ta mbështesin atë propozim janë të mëdha, por a do ta mbështesë atë shumica e republikanëve?", thotë Molly Reynolds nga instituti Brookings.

Koha për një betejë për projektligjin e imigracionit po mbaron ndërsa të enjten është dita e fundit e punës së Kongresit para një pushimi një javor.

Mattis: Turqia të përqendrohet në luftën kundër ISIS

BRUKSEL, 15 SHKURT - Ministri amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, i kërkoi Turqisë të përqendrohet në luftën kundër grupit të Shtetit Islamik, ndërkohë që tensionet me këtë aleat të NATO-s janë në nivelin më të lartë që prej operacionit ushtarak turk në veri të Sirisë kundër forcave kurde aleate të Uashingtonit. "Ne po mbajmë një dialog të hapur dhe të ndershëm dhe mendoj se jemi pranë arritjes së marrëveshjeve", deklaroi Mattis në një konferencë shtypi në përfundim të një takimi dyditor me homologët e NATO-s në selinë e Aleancës në Bruksel. "Mattis takoi homologun turk, Nurettin Canikli dhe i kërkoi një përqen-

drim në fushatën për të mundur Shtetin Islamik dhe për të penguar çdo mbetje të organizatës terroriste të rivendoset në Siri", thuhet në një komunikatë të Pentagonit.

"Mattis pranoi legjitimitetin e kërcënimeve që organizatat terroriste përbëjnë për sigurinë kombëtare turke", thekson komunikata. "Ata ranë dakord për të vazhduar bashkëpunimin e tyre ushtarak", shtoi Pentagoni.

Ky takim u zhvillua një ditë para vizitës në Ankara të kreut të diplomacisë evropiane, Rex Tillerson, i cili do të takohet me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan, para se të takojë homologun, Mevlut Cavusoglu.



Ramaphosa, presidenti i ri i Afrikës së Jugut

JOHANESBURG, 15 SHKURT - Parlamenti i Afrikës Jugore zgjodhi të enjten zyrtarisht Cyril Ramaphosa si presidentin e ri të vendit.

Kreu i Gjykatës së Lartë Mogoeng Mogoeng tha se Ramaphosa mund të zgjidhej pa votim pasi ishte i vetmi kandidat i propozuar për këtë post.

Zgjedhja e Ramaphosa erdhi disa orë pasi Jacob Zuma dha

dorëheqjen "me efekt të menjëhershëm". Prej disa ditësh udhëheqësit e Kongresit Kombëtar Afrikan, partisë në pushtet, i kërkuan Zuma të largohet nga detyra që mbante prej 9 vitesh, pas akuzave për korrupsion.

Presidenti i ri Ramaphosa përballat me sfida të shumta, ndër të cilat rindërtimi i ekonomisë pas një stanjacioni të gjatë. Pas

dorëheqjes së Zuma-s vlera e monedhës së Afrikës së Jugut, pësoi rritjen më të fortë në tre vjet kundrejt dollarit.

Zuma u përpoq ta shtyjë dorëheqjen e tij deri në qershor, por udhëheqësit e Kongresit Kombëtar Afrikan kërcënuan se do të zhvillonin një votim mosbesimi ndaj tij të enjten, nëse nuk do të jepte dorëheqjen e menjëhershme.



Urrime dita e Pavarësisë

AL-PETROL

10
VJET



AL-PETROL

Cilësi e garantuar

www.alpetrol-ks.com



**Kosovë,
urime 10 vjetori!**

IPKO

4G

Ukrime 10 Vjet Pavarësi

 mobile 3G 4G



Urime **10**
VJETORI
i PAVARËSISË
SË KOSOVËS



D E K A D Ë



LAURETA VINCA MULLIQI
"Rrugëtimi i pavarësisë"



SARANDA XHEMAJLI
"Heroi ynë"



ARBENITA KRYEZIU
"Egzistenca"



ALBULEN NEZIRI
"Pa titull"

URIME 10-VJETORI I PAVARËSISË!





Urime pavarësinë



URIME KOSOVË!

**10 VJET.
PAVARËSI**

#KOSOVA10





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency



**AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
UA URONË 10 VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS**

KOSOVA 10 VJET PAVARËSI
KOSOVO 10 GODINA NEZAVISNOSTI
KOSOVO 10 YEARS OF INDEPENDENCE

*Urime 17 shkurti
dita e Pavarësisë së*

Kosovës



PESTOVA





REPubliKA E KOSOVËS
REPubliKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN
MINISTRAS TVO ZA EVROPSKE INTEGRACIJE / MINISTRY OF EUROPEAN INTEGRATION



Ministria e Integritimit Evropian uron gjithë qytetarët
e Republikës së Kosovës me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë



Republika e Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik



KOSOVA 10 VJET PAVARËSI
KOSOVO 10 GODINA NEZAVISNOSTI
KOSOVO 10 YEARS OF INDEPENDENCE

Në 10-vjetorin e pavarësisë, MKRS-ja dha çmimet për letërsi

Çmimi Vjetor për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" iu dha shkrimtarit Rushit Ramabaja, me një korpus prej 36 veprave letrare në disa zhanre të ndryshme, si: romane, novela, tregime, drama, poezi, kritikë letrare, eseistike dhe monografi

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Në kuadër të aktiviteteve të para para që do të organizohen sipas agjendës shtetërore për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në një ceremoni solemne ka bërë ndarjen e Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe çmimeve vjetore të tjera për letërsi.

Çmimi Vjetor për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" iu dha shkrimtarit Rushit Ramabaja, me një korpus prej 36 veprave letrare në disa zhanre të ndryshme, si: romane, novela, tregime, drama, poezi, kritikë letrare, eseistike dhe monografi.

Juria ka vlerësuar se Rushit Ramabaja, si një autor sui generis, bën pjesë në panteonin e vlerave krijuese kombëtare dhe denjohet për t'u nderuar me çmimin "Azem Shkreli", i cili ka edhe një vlerë financiare prej pesë mijë eurove.

Çmimi për prozë "Anton Pashku" shkoi për shkrimtarin Fatmir Halimi për veprën "Dy vdekjet e një jetë" që, sipas jurisë, autori në këtë vepër trajton njëkohësisht temën e luftës dhe atë të dashurisë.

Çmimi për veprën më të mirë në poezi "Ali Podrimja" u nda përgjysmë për shkrimtarët Ismail Sylja për veprën poetike

"Atdheu im i ngrysur", që përmes elokuencës lirike përmbyll epizmin, duke pasur si pikë fillestare verbën jo vetëm petk popullore dhe për poetin Ragip Sylaj për veprën "Kam drojë për ty" si njërin prej zërave reprezentativ të poezisë shqipe me një bartje të shenjë filozofike e meditative.

Juria ka vlerësuar se për këtë vit çmimi për fëmijë dhe të rinj "Vehbi Kikaj" të ndahet në dysh për shkrimtarët Mexhit Mehmeti "Ecejaket e Hero Lindit" për tregimet që bartin dhe gërshetojnë mesazhin për jetën e rinisë; respektivisht Avni Deharin për përmbledhjen e tregimeve "Flakadanët e lirisë" që përçon mesazhin përmbajtësor për historinë e lavdishme të epokës së Skënderbeut.

Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistike "Ibrahim Rugova" iu dha Arben Veselajt për studimin "Tema Kadareane", i cili ka analizuar dhe i ka zbërthyer veçantitë stilistike dhe gjuhësore të publicistikës dhe eseistikes së tërë opusit eseistik të Ismail Kadaresë.

Kurse çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas "Pjetër Bogdani" shkoi për Orjela Stefanin për veprën "Njerëzit dhe ingranazhet" të Ernesto



Sabatos, të cilën juria e ka vlerësuar se ka arritur ta tejkalojë sfidën e përkthimit të një libri problematik në aspektin tematik dhe terminologjik.

Secili nga çmimet do të shpërblen me vlerë monetare nga 2 500 euro, kurse laureatët që ndajnë çmimin në një kategori shpërblehen me shumën prej 1 250 eurosh.

Shpërblimet janë të përcaktuara sipas Rregullores nr. 06/2015 (MKRS) për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi.

Laureatët morën çmimet respektive në bazë të vendimit të jurisë profesionale në përbërje të Hysen Matoshit, Merxhan Abdylit, Brikenë Ceraja-Beka, Shkëlqim Millaku dhe Qazim

Thaçi.

Ministri Gashi çmimet e ndara i ka cilësuar si një mirënjohje të institucioneve, punën dhe krijimtarinë letrare të shkrimtarëve dhe autorëve tanë ku, sipas tij, përkrahja e ministrisë konsiderohet edhe si një nxitje për rritjen e vlerave të mirëfillta artistike. "Unë si ministër e vlerësoj lart ndarjen e këtyre çmimeve për letërsi, sepse besoj se duke ndarë këto çmime në baza të rregullta vjetore, ne i kontribuojmë edhe stimulimit dhe nxitjes së krijuesve të shkruajnë dhe ta pasurojnë artin e fjalës sonë të shkruar", ka thënë Gashi.

Ministri Gashi ka thënë se MKRS-ja vit pas viti ka rritur përkrahjen për botimin, blerjen dhe shpërndarjen e librit si një politikë kulturore e cila ka për

synim avancimin dhe shtimin e artit letrar në vendin tonë.

Laureati Rushit Ramabaja u shpreh se ndihet i lumtur në qoftë se ka arritur t'ia përçojë lexuesit sadopak mesazhin e të mirës, të bukurës dhe të humanes. "E ndiejmë veten të nderuar natyrisht që sot, në 10-vjetorin e shtetësisë së Kosovës, dmth. të Dardanisë sonë të moçme, po e marrim këtë vlerësim pikërisht nga njerëzit tanë, pikërisht nga Ministria jonë e Kulturës, pikërisht nga shteti ynë që në themelet e saj u flijuan aq breza gjatë shekujve e deri te të rënë të UÇK-së. Urojmë që në 10 vjetëshat dhe në shekujt e ardhshëm njeriu të bëhet më i mirë dhe shteti ynë më i mbarë e më i fuqishëm", ka thënë Ramabaja.

Hapet ekspozita '10 vjet dritë dhe liri'

Ekspozita është organizuar në objektin e Galerisë së Fakultetit të Arteve, ku në këtë ekspozitë do të prezantohen punimet e realizuara nga nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar të Komunës së Prishtinës.

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Për nder të 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, drejtorja e Arsimit në Komunën e Prishtinës, në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ka hapur ekspozitën me temë "10 vjet dritë dhe liri".

Ekspozita është organizuar në objektin e Galerisë së Fakultetit të Arteve, ku në këtë ekspozitë do të prezantohen punimet e realizuara nga nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar të Komunës së Prishtinës.

Planifikimi dhe organizimi i ekspozitës është realizuar në koordinim me drejtuesit e Fakultetit të Arteve dhe drejtuesit e institucioneve edukativo-arsi-

more dhe do të jetë e hapur për vizitorë deri më 16 shkurt 2018.

Në këtë ekspozitë secili institucion edukativo-arsimor është përfaqësuar me nga tre punime, të punuar nga nxënësit e shkollave të tyre dhe tre punimet më të mira të nivelit të arsimit të mesëm të ulët dhe atij të mesëm të lartë do të shpërblehen.

Qëllimi i këtij aktiviteti, pos shënimit të dhjetëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ekspozimit të punimeve të nxënësve, është edhe identifikimi i talenteve të rinj, nxirrja në pah e shkathtësive dhe kompetencave të tyre dhe mbështetja e tyre drejt zhvillimit të imagjinatës krijuese e profesional në fushën e artit.



E jashtëzakonshme

Balerina 77-vjeçare

Suzelle Poole është një grua e moshuar, e cila dashuron kërcimin dhe asgjë nuk mund ta ndalë që të vazhdojë të performojë, pavarësisht viteve që mban në kurriz. Balerina 77-vjeçare ka udhëtuar në të gjithë botën për të dhuruar performanca, ndërsa tani mëson një gjeneratë tjetër të balerinave. "Fillova të kërcëj para 70 vjetësh. Vazhdoj të merrem ende me kërcim", është shprehur balerina 77-vjeçare.



FOTO E DITES



Një fëmijë kërcen me balona në formë zemre pas çiftit në Ditën e Shën Valentinit në Indi. /Reuters/

E rrallë

Akullorja më e rrezikshme në botë

E quajtur "akullorja më e rrezikshme në botë", ajo u krijua posaçërisht për ditën e Shën Valentinit nga Aldwych Cafe në Skoci. Akullorja është 500 herë më pikante se salca djegëse Tabasco. Sipas vëllezërve dhe bashkëpronarëve të kafenesë, Lee dhe Martin Bandoni, ideja për këtë akullore potencialisht vdekjeprurëse vjen nga Italia.



BARSOLETA E DITËS



Mësuesja: Kush dëshiron të përgjigjet për mësimet e djeshme?
Beni: Mësuese, mësuese...
Mësuesja: Po, Beni!
Beni: Bën të dal pak jashtë?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

“FERDINAND”

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) “FIFTY SHADES FREED”

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley



Në ora 22:00 (PG-13)

“THE COMMUTER”

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Shumë persona do të paguanin për të qenë në kushtet në të cilat gjendeni ju momentalisht. Nuk po e vlerësoni siç duhet atë çfarë ju ofrohet.



DEMI

Ka ardhur momenti që ju të merrni vendime lidhur me jetën sentimentale. Nuk mund të shtyni pafund një situatë që ka nevojë për zgjidhje.



BINJAKËT

Ndiheni më të mbushur sot nga shumë objektiva që keni mundur të realizoni. Kjo ka ndikuar edhe në gjendjen tuaj shpirtërore duke ju bërë më gazmor.



GAFORRJA

Tashmë ajo që po bëni nuk është më çështje fati. Jeni ju që me ambicien tuaj keni arritur të çani edhe aty ku ka qenë e pamundur.



LUANI

Ka njerëz që duan t'ju udhëheqin drejt përvojave të reja profesionale. Edhe pse jeni pak skeptik, duhet ta provoni rritjen në karrierë.



VI RGJËR ESHA

Keni hequr dorë nga rutina juaj dhe po provoni situata të reja që nuk do t'i kishit menduar më parë. Kjo do t'ju bëjë njëri më të mirë.



PESHORJA

Sot do të ketë të reja në jetën tuaj që do të ndryshojnë çdo aspekt të saj. Të tjerët janë duke pritur nga ju disa gjëra.



AKREPI

Disa situata të komplikuar do t'ju shkaktojnë jo pak tension sot, por do të arrini të dilni në krye me sukses. Familjarët janë duke përgatitur një surprizë për ju.



SHIGJETARI

Sakrificat tuaja do të shpërblehen sot. Edhe pse mendoni se gjërat nuk po shkojnë siç duhet, duhet të jeni më optimist sepse do të shihni se është e kundërta.



BRICJAPI

Mos u mërzisni me disa fakte që po ua vënë përpara të afërmit tuaj. Do të shikoni që keni besuar tek një person që nuk e meritonte.



UJORI

Duhet të jeni me në brendësi të gjërave që po ndodhin në ambientin tuaj profesional ose akademik. Keni marrë të mirëqena shumë situata që ju kanë thënë.



PESHQIT

Nëse mbani fjalën e dhënë sot, do të jeni mjaft korrekt me ata persona që po bashkëpunoni. Dëshira për pushime ka kohë që ju ka kapluar.


Kimi në mesin e yjeve që bën thirrje të mos përdoren armët



Kim Kardashian është në mesin e të famshmëve që ka bërë thirrje për kontroll më të rreptë të armëve. Thirrja e saj lidhet me sulmin që ndodhi në një shkollë në

Florida ku të vdekur kanë mbetur 17 nxënës. "Ua kemi borxh fëmijëve tanë dhe mësuesve tanë t'i mbajmë të sigurt derisa ata ndodhen në shkollë", ka shkruar Kimi në rrjetet sociale.

Selena Gomez i rikthehet muzikës



Pak kohë më parë në media ka qarkulluar lajmi se pas ribashkimit të bujshëm, Selena Gomez dhe Justin Bieber ishin ndarë sërish. E kundër kësaj lidhje u përfol se ishte edhe nëna e Selenës por, mesa duket, ishin thjesht

thashetheme sepse çifti jo vetëm se nuk janë ndarë, por duken shumë të lumtur përkrah njëri-tjetrit. Selena ka thënë se do të vijë shumë shpejt me gjëra të reja për fansat e saj, ndoshta me një këngë ose me një album muzikor.




Leonardo DiCaprio fotografohet me të dashurën e re

Leonardo DiCaprio ka një modele të re në jetën e tij. Pasi kishin kaluar pushimet bashkë në Aspen të Kolorados, fituesi i çmimit Oscar është parë sërish me 20-vjeçarën Camila Morrone në festën e ditëlindjes

së Ellen DeGeneres. Aktori 43-vjeçar dhe modeluesja nga Argjentina kanë shkuar në festë bashkë derisa DiCaprio është parë duke e vendosur dorën në pjesën e poshtme të shpinës së Morrone.

Padia e Kanye Westit, këngëtari fiton rreth 10 milionë dollarë


Kanye Westi ka arritur ta fitojë betejën ligjore me kompaninë "Lloyd's of London", e cila kishte organizuar turneun e tij në vitin 2016, "Saint Pablo". "Lloyd's of London" kishte refuzuar ta paguajë Kanye Westin sipas kontratës, për koncertet e anuluar të tij, pasi kishte përjetuar një krizë nervore. Megjithatë asnjë raport mjekësor nuk e mbështeti këtë teori, atëherë "Lloyd's of London" është pajtuar ta paguajë shumicën e shumë prej 10 milionë dollarësh sa kishte kërkuar Kanye.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



SPORT



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEICESTER - SHEFF UTD

1-1

GIRONA - LEGANES

1

HERTHA BERLIN - MAINZ

GG3+

Albini, i 50-ti në garën e lëshimit

Garuesi Albin Tahiri në ditëlindjen e 29 ka garuar në garën e lëshimit, nga e cila ka dalë i 50-ti. "Bëra një lëshim të mirë ashtu siç e paramendoja. Nuk bëra ndonjë gabim. Mendova se isha më i shpejtë, mirëpo jam i kënaqur edhe me kaq", ka thënë Tahiri

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Skitari Albin Tahiri që po e prezanton Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore "PyeongChang2018" ka garuar të enjten në garën e lëshimit. Kjo garë ishte e veçantë për skitarin në fjalë, pasi ishte edhe ditëlindja e 29 e tij. Tahiri nga 57 garues është renditur i 50, kurse e ka vlerësuar se ka pasur paraqitje të mirë. "Po ndihem shumë mirë. Ishte gara ime e veçantë e lëshimit dhe ditëlindja. Po ashtu edhe koha ishte shumë e mirë dhe nuk mund të ishte keq. Bëra një lëshim të mirë ashtu siç e paramendoja. Nuk bëra ndonjë gabim. Mendova se isha më i shpejtë, mirëpo jam i kënaqur edhe me kaq. Të premten është një garë e re, një shteg i ri, një rast i ri. Është super slallomi i madh (super g). Do të shohim çfarë do të ndodhë. Unë do të mundohem të bëj më të mirën", ka thënë Tahiri, i cili pati kohën

1:48.81 sekonda. Ndërsa i kënaqur me paraqitjen e Albinit ishte edhe trajneri i tij Agim Pupovci. Ky i fundit ka bërë me dije se ka mundur të renditet edhe më mirë, por edhe pozita e 50 nuk është e keqe. "Kjo është ajo që e kemi pritur. Ndoshta ka mundur edhe 2-3 vende më mirë, por në përgjithësi jam i kënaqur me paraqitjen në këtë shteg, që vlerësohet mjaft i vështirë", ka deklaruar Pupovci. Lidhur me garimin e Tahirit ka folur për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës edhe kryetari i KOK-ut, Besim Hasani, i cili ka deklaruar: "Ishte ditë e veçantë. Albini ka ditëlindjen dhe zhvilloi disiplinën ku ndihet më së miri. Besoj se rezultati është mjaft i mirë, duke marrë parasysh se sportistët e tjerë kanë mundësi të shkojnë gjatë sezonit dhe të stërvitin aty ku ka kushte më të përshtatshme. Për ne paraqitja ka rëndësi të jashtëzakonshme, sepse para gjithë këtyre pjesë-



marrësve po përfaqësohet Kosova, pikërisht në muajin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës".

Mëhilli e mbyll në vendin e 53-të "Slallomin gjigant"

Garuesja shqiptare Suela Mëhilli e mbyll në vendin e 53-të garimin e saj në "Slallomin gjigant" në ski për femra, në Lojërat

Olimpikë Dimërore të Pyeongchangut, një rezultat ky më i mirë sesa ai i Sochit në vitin 2014, kur u rendit në vendin e 60. Dy minuta, 46 sekonda e 57 të qindtat ishte koha e përgjithshme e regjistruar nga skiatorja shqiptare në përfundim të dy raundeve të kësaj gare. Në raundin e parë, Mëhilli e përshkoi pistën me 1 minutë, 24 sekonda e 67 të qindtat, duke u

renditur në vendin e 60. Në raundin e dytë, paraqitja e saj ishte edhe më e mirë, teksa ajo e uli me rreth 3 sekonda kohën e raundit të parë, në 1 minutë, 21 sekonda e 9 të dhjetat, për t'u renditur në vendin e 54-t, raporton "TCH". Suela Mëhilli do të garojë të premten në "Slallom", garë e cila ishte parashikuar të zhvillohej më 14 shkurt, por që u shty për shkak të erërave të forta.



Kosova dhe Shqipëria ngrehen nga një pozitë

PRISHTINË, 15 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është ngritur për një pozitë në renditjen e FIFA-s për muajin shkurt. Një muaj më parë Kosova është renditur në pozitën e 178,

por rënia për shtatë pozita e Belizes ia ka dhënë mundësinë Kosovës ta përmirësojë minimalisht renditjen e saj. Në anën tjetër edhe Kombëtarja e Shqipërisë e ka fituar një pozicion në renditjen

e përgjithshme të FIFA-s, edhe pse nuk ka zhvilluar asnjë ndeshje gjatë muajit të fundit. Kuqezinjtë kanë përfituar nga rënia e Algerisë në vendin e 60, duke u ngjitur në të 59-in.

Batatina thumbon trajnerët nga Shqipëria

BESIANË, 15 SHKURT - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka gjetur kohë t'i thumbojë edhe trajnerët nga Shqipëria, pasi e eliminoi Trepçën '89 nga gara e Kupës. Skuadra mitrovicase drejtohet nga një trajner nga Shqipëria, kurse Batatina ka shprehur mendimin se trajnerët në Kosovë janë më të mirë. "Trajnerët e Kosovës që janë pa

punë duhet të rrinë të gatshëm se shumë shpejt kanë për t'u liru pozitat për ju, sepse ju jeni më të mirë. Ata që iu vërshulën Superligës shumë shpejt kanë për t'u rikthyer përmes autostradës. Kanë menduar se janë superiorë dhe mund ta bëjnë diferencën kundër nesh, por jo, ne jemi më të përgatitur se ju dhe shumë shpejt iu rik-

theheni mbrapa, sepse ne kemi kuadro të mira të trajnerëve në Kosovë. Mos i nënvlerësoni trajnerët e Kosovës, sepse kanë vizion më të mirë dhe janë ata që japin më shumë se ata që vijnë për të bërë emër dhe karrierë tek ne, por kanë gabuar shumë sepse nuk kanë pyetur se kush qëndron përball tyre", ka thënë Batatina.



UEFA mund ta dënojë rënd Skënderbeun

TIRANË, 15 SHKURT - Klubi i Skënderbeut është dënuar me 10 vjet përjashtim nga të gjitha kompeticionet e UEFA-s. Komisioni i Disiplinës në UEFA

ka marrë vendimin drastik për klubin korçar, duke i dhënë kështu një përjashtim shumë të rëndë. "Panorama-Sport" ka mësuar ekskluzivisht se

Skënderbeu është dënuar në vendimin e datës 7 shkurt 2018, nga komisionet disiplinore pranë organit më të lartë të organizatës evropiane

të futbollit. Gjithashtu, bashkëngjitur me dënimin prej 10 vjetësh, Skënderbeut i shtohet edhe një gjobë e majme prej plot 1 000 000 eurosh.



Golden State humbet ndaj Portlandit

OAKLAND, 15 SHKURT - Kampionët e Golden State u mundën 123-117 nga Portlandi në sfidën e radhës në NBA, humbje që i kushton shumë skuadrës së Warriorsit, që humbet kryesimin e renditjes në Perëndim. Ndeshje me rivalitet dhe emocione, fituar me meritë nga Portlandi, që korri suksesin e 33-të sezonal falë 44 pikëve të Lillardit dhe 29 të McCollumit. Për Warriorsin u dallua Duranti me 50 pikë, por që mbetën për statistikë. Nga kjo humbje përfiton Houstoni, që mundi 100-91 Sacramento, duke u ngjitur në krye të renditjes në Perëndim, sfidë ku diferencën e bëri Hardeni me 28 pikë, ndërkohë që të 5 titullarët e ekipit teksan realizuan mbi 10 pikë. Fiton edhe New Orleansi, që mundi 139-117



Lakersat, ndeshje e dominuar nga vendësit, ku u dallua Davisi me 42 pikë e 15 rebaunde, raporton "TeleSport". Zhgënjën edhe skuadra e Bostonit, që dorëzon kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes. Basketbollistët e Celticsit u mundën 129-119 nga Clippersu, në një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Irvingu realizoi 33 pikë për vendësit, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Clippersin 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë, me Jordanin që ishte autor i 30

pikëve dhe 13 rebaundeve. Fitore në sekondat e fundit korri Philadelphia, që mundi 104-102 Miamin, ndeshje emocionuese deri në fund, ku gjithçka u vendos nga Simmons, që realizoi 18 pikë, 12 rebaunde e 10 asistime. Po 104-102 fiton edhe Charlotte, që mposhti Orlandon (Howard 22 pikë e 13 rebaund), ndërsa skuadra kanadeze e Torontos fitoi 122-98 ndaj Chicagos (Ibaka e Lowry nga 20 pikë secili). Falë këtij sukcesi, Toronto ka marrë kreun e renditjes në Lindje.

REZULTATET

Detroit - Atlanta	104-98
Orlando - Charlotte	102-104
Philadelphia - Miami	104-102
Brooklyn - Indiana	103-108
New York - Washington	113-118
Boston - Clippers	119-129
Chicago - Toronto	98-122
Houston - Sacramento	100-91
Memphis - Oklahoma	114-121
New Orleans - Lakers	139-117
Utah Jazz - Phoenix	107-97
Portland - Golden State	123-117

Gjermania shton bilancin e medaljeve

PYOENGCHANG, 15 SHKURT - Gjermania shton numrin e medaljeve të fituara në Lojërat Olimpikë të Pyeongchangut. Në garën dyshe në disiplinën Luge, ky shtet siguroi medaljen e artë dhe të bronzit. Më të mirët e kësaj gare u treguan Wendl dhe Arlt me kohën 45 sekonda e 877 të mijtat, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi çifti Egert-Beneken. Mes dy çifteve gjermane, me medaljen e argjendtë u pozicionuan austriakët Penz dhe Fichler. Tjetër medalje të artë Gjermania e fitoi në garën e kombinuar, që është një ndërthurje e kërcimit nga trampolina me ski dhe garës Cross Country 10 km. Ai që ia dhuroi këtë medalje skuadrës gjermane ishte Erik Frenzel, me 24 minuta e 51.4 sekonda. Në vendin e dytë u rendit japonezi Watabe, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi austriaku Klapferi. Në disiplinën e Snowboard Halfpipe shkëlqeu amerikani Shaun White, i cili fitoi medaljen e artë, e treta për të pas Lojërave Olimpikë të Torinos dhe Vankuverit, në 2006-n dhe 2010-n. Në vendin e dytë u rendit japonezi Hirano, ndërsa në të tretin



australiani Scotty James. Në patinazhin e shpejtë vijon dominimi holandez. Në garën e 1000 m për femra, medaljen e artë e fitoi Ter Mors, me 1 minutë, 13 sekonda e 56 të qindtat. Në vendin e dytë dhe të tretë u renditën japonezet Kodaira dhe Takagi. Në renditjen e

përgjithshme, Gjermania kryeson bindshëm me 8 medalje ari, 2 argjendi dhe 3 bronzi. Në vendin e dytë është ngjitur Norvegjia, me 5 medalje ari, 7 argjendi dhe 4 bronzi, ndërsa e treta është Holanda me 5 medalje të arta, 4 të argjendta dhe 2 të bronzta.

SHKURT

Gashi rikthehet te Hajvalia

Futbollisti Gëzim Gashi është rikthyer në skuadrën e Hajvalisë. Lajmin e ka konfirmuar trajneri Emin Bajrami, i cili i ka uruar çdo të mirë futbollistit Gashi. Ky i fundit në të kaluarën, kur ishte pjesë e skuadrës së Hajvalisë, ishte kapiten i skuadrës. Tash skuadra e Hajvalisë bën gara në Ligën e Parë dhe renditet në pjesën e poshtme të tabelës.

Ronaldo: Isha më i miri kundër PSG-së

Real Madridi e ka fituar ndeshjen e parë ndaj PSG-së (3-1), kurse Cristiano Ronaldo realizoi dy gola. Ylli portugez beson se ka qenë më i miri i kësaj ndeshje. "Është gjithmonë e veçantë kur ti shënon dhe ekipi fiton ndeshjen. Kam qenë më i miri në fushë në këtë ndeshje. E kam ndihmuar skuadrën të fitojë duke shënuar dy gola", ka thënë Ronaldo, i cili, lidhur me kualifikimin, ka shprehur mendimin se ende asgjë nuk ka përfunduar.

Emery: Mund ta përmbysim rezultatin në Paris

PSG-ja është mposhtur nga Real Madridi me rezultat 3-1, por trajneri Unai Emery është optimist se ekipi i tij mund ta përmbysë disavantazhin e dy golave në ndeshjen e kthimit. "Ekipi im luajti ndeshje të mirë. Është një rezultat i ashpër për ta marrë. Futbollistët luajtën me personalitet. Ndoshta na mungoi finalizimi. Mendoj se merituar rezultat më të mirë për performancën tonë. Ndeshja u vendos nga detaje të vogla. Po mendoj për shanset që kemi në vendin tonë para fansave tanë. Kemi shansin ta përmbysim rezultatin. Mementalisht jam optimist për ndeshjen e dytë. Rezultati është 3 me 1, por lojë që bëmë nuk e reflekton rezultatin", ka thënë Emery.

Dybala, gati ndaj Torinos

Juventusit është në garë për titullin e kampionit në Serinë A me Napolin. Ndeshjen e radhës Juventusit e zhvillon të dielën ndaj Torinos dhe lajm i mirë për "Zonjën e Vjetër" është fakti se Paulo Dybala do të jetë i gatshëm për këtë ndeshje. Dybala mungoi edhe në ndeshjen e fundit në Ligën e Kampionëve ku Juventusit luajti 2-2 ndaj Tottenham Hotspurit.

Weneri nuk rinovon me Leipzigun

Sulmuesi gjerman i RB Leipzig, Timo Werner, u ka dhënë shpresa ekipeve të mëdha evropiane, të cilat janë të interesua për shërbimet e tij. Sipas "Daily Star", Weneri ka refuzuar kontratën e re të skuadrës gjermane dhe është i gatshëm të largohet. Për të interesim kanë shprehur disa prej skuadrave më të mëdha evropiane si Liverpool, Manchester United, Chelsea, Real Madrid, Barcelona dhe Atletico Madrid. Kontrata aktuale e gjermanit me Leipzigun skadon në verën e vitit 2020.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë / Ministarstvo za Inovacije preduzetništvo/
Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme / Departmanza Finansije i
Opšte Usluge / Department of Finance and General Services

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme - Divizioni për Buxhet dhe Financa

Numri i Konkursit: APF0003023

Vendi i punës: Zyrar i Lartë për Buxhet dhe Financa - BF/200

Koeficienti : 8.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Periudha provuese: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i divizionit për Buxhet dhe Financa

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Hartoni planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre si dhe bënë pranimin e të gjitha Urdhër-Obligim- Pagesave në lidhje me shpenzimet kapitale nga lista për regjistrimin e inventarit;
- Analizon dhe vlerëson propozimet buxhetore dhe bënë ekzaminimin e tyre duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë si dhe bënë azhurnimin e ditarit të pasurive i cili mbahet në tabelë MS Excel ose në baza tjera të të dhënave;
- Monitoron shpenzimet e buxhetit gjatë gjithë vitit dhe rekomandon rialokimin e buxhetit kur është e nevojshme si dhe përgatitë raporte mbi shpenzimet buxhetore;
- Bën klasifikimin e pasurive kapitale dhe jokatitale sipas dispozitave Udhëzimit Administrativ për Menaxhimin e Pasurisë;
- Zhvillon dhe zbaton politikën, procedurat dhe praktikën financiare dhe operative të cilat lehtësojnë dhe mbështesin menaxhimin financiar;
- Siguron disponueshmërinë dhe alokimin e buxhetit në përputhje me procesin e fillimit të çdo aktiviteti dhe buxhetin e planifikuar, bën regjistrimin softuerik të hyrave buxhetore;
- Përcjell dhe barazon mjetet buxhetore në nivel të Ministrisë, departamenteve dhe divizioneve në kuadër të Ministrisë;
- Bën barazimin analitik të mjeteve buxhetore në emër të vijave të përcaktuara buxhetore;
- Kryen të gjitha punët shtesë me të cilat ngarkohet nga ana e udhëheqësit të buxhetit dhe financave.

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universitare në drejtimin ekonomik, financa, kontabilitet,
- 3 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internetit);

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme - Divizioni për TI dhe Shërbime Logjistike

Numri i Konkursit: APF0003021

Vendi i punës: Zyrar i Depos - AD/220

Koeficienti : 6.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Periudha provuese: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për organizimin e depos në përputhje me procedurat dhe politikën e organizatës;
- Mbanë evidenca të sakta dhe të plota të mallit në kopje fizike dhe elektronike dhe ruan të gjitha të dhënat relevante të mallit;
- Bënë pranimin e mallit , kujdeset për mirëmbajtjen dhe bënë shpërndarjen sipas kërkesave;
- Vlerëson dhe kujdeset për hapësirën e nevojshme për deponim të mallit dhe përgatitë planet e deponimit të mallrave në ardhje;
- Përgatitë raporte të rregullta për stoqet e mallrave në depo;
- Përgatitë të gjitha procedurat dhe hapat e nevojshme për asgjësimin e mallrave;

- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi i nevojshëm :

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);
- Arsimim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Numri i Konkursit: APF0003022

Vendi i punës: Asistent Ekzekutiv - AD/130

Koeficienti : 7.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Periudha provuese: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve , si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Komunikon direkt , dhe në emër të mbikëqyrësit me njësit organizative brenda institucionit për çështjet e iniciuara nga mbikëqyrësi;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-mailit për mbikëqyrësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Ndihmon mbikëqyrësin në caktimin dhe koordinimin e takimeve të ndryshme dhe të merr pjesë në takime nëse është e nevojshme;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi i nevojshëm :

- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access);
- Arsimim i bachelor në drejtimet Juridik, Ekonomi, Filologjik, Edukim, trajnim përkatës dhe së paku katër (4) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative.

Procedura e konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Formularët për aplikim mund të merren në Ndërtesën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Webfaqen <http://www.min-rks.net>

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Ndërtesën e Punëve të Jashtme, kati i tretë –Prishtinëse me postë.

Informata e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kohëzgjatja e kontratës sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i konkurrimit është prej datës 16/02/2018 deri me datë 02/03/2018 deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 00381 38 200 69 507



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo/Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Departman za Finansije i Opšte Usluge/Department of Finance and General Services

Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo na osnovu Zakona o javnoj službi Republike Kosovo br.03/L-149 i Uredbe br. 02/2010 o postupku zapošljavanja u javnoj službi Republike Kosovo, objavljuje:

OGLAS ZA ZAPOSŁJAVANJE

Departman finansija i opšte poslove- Divizije za budžet i finansije

Broj Konkurs:APF0003023

Radno mesto:Visoki zvaničnik za budžet i finansije- BE/200

Koeficijent: 8.00

Trajanje imenovanja: Na neodređeno vrijeme

Probni period: 12 (dvanaest) meseci

Nadzornik: Rukovodioc divizije za budžet i finansije

Dužnosti i odgovornosti:

- Razvija plan rada u skladu sa pretpostavljenim u sprovođenju zadataka utvrđenih u osnovnim ciljevima i daje preporuke u vezi sa sprovođenjem ovih, kao i prima sve nalog- obaveze- isplate u vezi kapitalnih izdataka iz liste za registraciju inventara;
- Analizira i ocenjuje predlog budžeta i njihov pregled razmatrajući ispravnost, tačnost i potpunost kao ažurira dnevnik imovine koji se održava u tabelama MS Excel ili drugim bazama podataka;
- Monitorira budžetske rashode tokom cele godine, i preporučuje ponovnu raspodelu budžeta gde je to potrebno i priprema izveštaja o budžetskim troškovima;
- Klasificira kapitalnu i ne kapitalnu imovinu prema odredbama Administrativnog uputstva o upravljanju imovine;
- Razvoj i sprovodi politiku, finansijske i operativne procedure i prakse koje olakšavaju i podržavaju finansijski menadžment;
- Osigurati dostupnost i raspodelu budžeta u skladu sa procesom pokretanja svake aktivnosti i planiranje budžeta, budžetski prihodi čini registraciju softvera;
- Prati i izjednačava budžetska sredstva za ministarstvo, departmana i divizija u okviru Ministarstva;
- Obavlja analitičku budžetsku izjednačenje u ime navedenih budžetskih linija;
- Obavlja sve dodatne poslove sa kojima se tereti od strane rukovodioca za budžet i finansije.

Potrebne kvalifikacije:

Univerzitetska diploma iz ekonomije, finansija, računovodstva .

- 3 godine radnog iskustva u struci;
- Znanje i iskustvo iz oblasti budžeta i finansije;
- Komunikacione veštine u planiranju rada i timskog liderstva;
- Istraživačke, analitičke, procenjujuće veštine, i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost u ispunjenju zadataka i rada pod pritiskom;
- Računarske veštine aplikacije programa (Word, Excel, Power Point, Access internetu);

Departman finansija i opšte poslove -Divizije za IT i logistike usluge

Broj Konkurs:APF0003021

Radno mesto: Zvaničnik depoa (depoista)

Koeficijent: 6.00

Trajanje imenovanja: Na neodređeno vrijeme

Probni period: 12 (dvanaest) meseci

Nadzornik: Rukovodioc divizije za IT i logistike usluge

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran za organizaciju skladišta u skladu sa politikama i procedurama organizacije;
- Vodi tačnu i punu evidenciju robe u fizike i elektronske kopije i čuva sve relevantne podatke o robi;
- Vrši primanje robe, vodi racuna o održavanju i vrši distribuciju prema zahtevima;
- Procenjuje i vodi racuna za potrebni prostor za skladištenje robe i priprema planove za skladištenje dolzne robe;

- Priprema redovne izveštaje za zalihe robe u skladištu;
- Priprema sve neophodne procedure i potrebne poduhvate u odstranivanju robe;
- Obavlja i ostale zadatke u skladu sa zakonima i zakonskim propisima koje pretpostavljeni s vremena na vreme, na razuman nacin može zahtevati:

Potrebne kvalifikacije:

- Sposobnosti u primeni procedura i administrativnih upustava za obavljanje radnih zadataka;
- Komunikacione veštine, uključujući sposobnost za tumačenje informacija, za davanje upustava i da prosledi informacije drugima;
- Sposobnosti u koordinisanju i nadgledavanju rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou;
- Poznavanja rada na kompjuteru i softverske aplikacije (Word, Excel);
- Srednje obrazovanje, odgovarajuće obuke i najmanje tri (3) godine radnog iskustva na tehničko administrativne oblasti.

Kancelarija generalnog sekretara

Broj Konkurs:APF0003022

Radno mesto: Ekzekutivni Asistent - AD/130

Koeficijent: 7,00

Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Probni period: 12 (dvanaest) meseci

Nadzornik: Generalni Sekretar

Dužnosti i odgovornosti:

- Obezbeđuje opštu administrativnu i tehničku podršku uključujući službenu poštu, telefonske pozive, skeniranje, slanje faksa i kopiranje dokumenata, popunjavanje izveštaja o troškovima i izradi dokumenata za razne sastanke;
- Komunicira direktno i u ime nadzornika sa organizacionim jedinicama u okviru institucije za slučajeve koje su pokrenute od strane nadzornika;
- Priprema i modifikira dokumente, uključujući prepiske, izveštaje, memorandume i e - maile za nadzornika;
- Prima i raspoređuje korespondenciju za nadzornika i brine o njenom napretku;
- Čuva i održava elektronske sisteme i fizičke kopije dokumenata i dosjea kancelarije nadzornika;
- Upravlja kalendarom sastanaka i drugih događaja za nadzornika i pomaže u rešavanju bilo kakvih tehničkih i administrativnih problema;
- Pomaže nadzornika u planiranju i koordinaciju sa raznim sastancima i učestvuje na sastancima ukoliko je potrebno;
- Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koje se mogu razumno zatražiti s vremena na vreme od strane nadzornika

Potrebna kvalifikacija:

- Poznavanje standardnih administrativnih/tehničkih procedura, iz tehničkog ili administrativnog delokruga;
- Sposobnost da radi na sopstvenu inicijativu u okviru određenih planova i procedura;
- Dobre komunikacione veštine, uključujući i sposobnost za tumačenje informacija, davanje instrukcija i prenos informacija drugima;
- Sposobnost da koordinira i nadzire rad osoblja na administrativnom i tehničkom nivou;
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);
- Edukacija bachelor, smer Prava, Ekonomije, Filološki fakultet, fakultet obrazovanja, odgovarajuće obuke i najmanje četiri (4) godine radnog iskustva u relevantnoj tehničkoj ili upravnoj oblasti

Postupak konkurisanja

Postupak konkurisanja je otvoren za spoljne kandidate, kao i za postojeće javne službenike koji uspunjavaju kriterijume konkursa. Prijava za zapošljavanje i opis radnog mesta mogu se preuzeti na zgradi Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo

Zvanični obrazac za prijavu, možete preuzeti na internet stranici: <http://www.min-rks.net>

Uz zahtev potrebne je priložiti sledeću prateću dokumentaciju: Popunjeni obrazac, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu treba da budu nostrifikovane od strane MONT), dokaz radnog iskustva, dve reference.

Korišćenje pogrešnog obrasca i obrazac nepopunjen traženim podacima, smatraće se nevažećim. Prijave se dostavljaju u zgradi Ministarstvo Inostranih Poslova, III sprat ili putem pošte.

Opšte informacije za sve kandidate

Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova, i dobrodošle su prijave od svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima javne službe, kao što je utvrđeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o javnoj službi u Republici Kosovo.

Trajanje ugovora prema ZJS, uključujući i period probnog rada.

Zbog velikog broja primljenih prijavi, kontaktiraće se samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Rok za prijave je od datuma 16/02/2018 do datuma 02/03/2018, do 16:00

Konkurs će ostati otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.

Zahtevi podneti nakon isteka roka za konkurs, neće biti uzeti u obzir.

Za dodatne informacije, molimo pozovite sledeći broj: 00381 38 200 69 507

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Hidro Forca" Sh.p.k. Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e hidrocentralit në lumin "Strazhë", komuna e Kaçanikut.


Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12. 03. 2018. në ora 11:00 në hapësirat e restorantit "Sharri", afër Veis Villave, tek Pishat në Strazhë, komuna e Kaçanikut, do të organizohet debat publik nga kompania "Hidro Forca" Sh.p.k. Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e hidrocentralit në lumin "Strazhë", komuna e Kaçanikut.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Isuf Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorj me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajazitit". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te saloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.


REPUBLICA E KOSOVË
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.574/15


GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike të kësaj Gjykate Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Shpejtim (Jasim) Morina, nga Arbana, Komuna e Prizrenit, me punë dhe banim në Gjermani, të cilën e përfaqëson i autorizuari Teki Bokshi, avokat nga Gjakova kundër të paditurit Danilo Rakoviq ish - nga Gjakova, tani i shpërngulur në Serbi me adresë të panjohur, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri, vlera e kontestit 1.000 euro me date 15.01.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurit Danilo Rakoviq ish-nga Gjakova tani i shpërngulur në Serbi me vendbanim të panjohur, të cilit tani nuk i dihet adresa e saktë, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati Sokol Dobruna nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.


REPUBLICA E KOSOVË
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.532/15


GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Malsor Kryeziu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve 1. Sadije (Bajram) Gashi e vajzërisë Çuni, e veja e Lushit, 2. Vesel Hisni Gashi, që të dy nga Gjakova, rr."Lekë Dukagjini" nr.192, Dardani (ish-Piskotë), kundër të paditurve: 1.Vidosava (Golub) Rashoviq, 2. Milorad (Slobodan) Rashoviq dhe 3.Velisha (Shqepan) Rashoviq, ish nga Piskota- Gjakovë, tani të shpërngulur në Serbi me adresë të panjohur, me propozim që të njëjtëve të iu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri, vlera e kontestit 3.700 euro, me date 15.01.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurve 1.Vidosava (Golub) Rashoviq, 2. Milorad (Slobodan) Rashoviq dhe 3.Velisha (Shqepan) Rashoviq, ish nga Piskota- Gjakovë tani të shpërngulur në Serbi me adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati Afrim Radoniqi, avokat nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi i tyre me prokurë, gjegjësisht deri sa Organi i Kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.


III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.


 **Gjej PUNË**

• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



 www.facebook.com/gjeipuneshpejite



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA_{ERE}

ME TRADITË

40

VJEÇARE



Kompania e sigurimeve
KOSOVA_{ERE}
Insurance Company

**Kompania e Sigurimeve
“Kosova e Re” të gjithë
qytetarëve të Kosovës ua uron
10-vjetorin e Pavarësisë**



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit 'Prishtina' sh.a. të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ua uron 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Kosovës!



*Ju Uron
uzjetorin
e Pavarësisë*

10





Qendra për Mjekësi Fizikale
dhe Rehabilitim

Nënna Naile

Banja në Kllokot - Kosovë



Tel&Fax: 0280 385 101, 0280 385 555 • Mob: 044 666 006, 045 385 555 • info@nenanaile.com • www.nenanaile.com



Tek ne do të gjeni ngrohtësi në katër stinët e vitit ...!



**Të gjithë qytetarëve
të Kosovës ua uron
10-vjetorin e Pavarësisë**



 **KOMUNA SKENDERAJ**


KOSOVA 10 VJET PAVARËSI
KOSOVO 10 GODINA NEZAVISNOSTI
KOSOVO 10 YEARS OF INDEPENDENCE

**KJO DITË E BËNË ZEMRËN TIME TË RRAHË ME KRENARI.
LE TË JETË LAVDIA E BREZAVE UDHËRRËFYES I SUKSESEVE DHE LUMTURISË.**

URIME 10-VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Bekim Fashari
Kryetar i K.K. Skenderaj



*...Kombeve
Kosovës, përfaqëso
Deklarata...*

10 

**URIME 10 VJETORI I
PAVARËSISË SË KOSOVËS**


www.kosovotelecom.com